FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 40	2000	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8689 datë 16.11.2000	Për parandalimin e përhapjes së infeksionit Hiv/Aids në Republikën e Shqipërisë	1897
Ligj nr.8693 datë 23.11.2000	Për ratifikimin e "Amendamentit të Konventës Financiare ndërmjet qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale – Itali për financimin e përbërësve të asistencës teknike për ndërmarrjen e ujërave dhe të ndërhyrjeve infrastrukturore në rrjetin hidrik, në kuadër të projektit të rehabilitimit të rrjetit hidrik të Tiranës"	1902
Ligj nr.8694 datë 23.11.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë, në bazë të termave të referencës së Klubit të Parisit, të 22 korrikut 1998, ndërmjet qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane"	1903
Ligj nr.8696	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e	

datë 23.11.2000	Vjenës "Për të drejtën e traktateve"	1913
Vendim i KM nr.634, datë 30.11.2000	Për disa ndryshime në vendimet nr.357, datë 7.7.2000, nr.511, datë 21.9.2000, nr.567, datë 23.10.2000, të Këshillit të Ministrave, dhe në planin e shpronësimeve për vitin 2000, për Ministrinë e Transportit, në objektet me financim të huaj	1940
Vendim i KM nr.636, datë 30.11.2000	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.328, datë 26.6.1995, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin ekonomik financiar të njësisë së transportit mjekësor me helikopterë"	1943
Vendim i KM nr.637, datë 30.11.2000	Për mbylljen e disa minierave të hekurnikelit në rrethet Pogradec dhe Librazhd	1944
Vendim i KM nr.638, datë 30.11.2000	Për mbylljen e disa minierave të kromit në rrethet Tropojë, Mat, Bulqizë, Pogradec dhe Librazhd	1945
Vendim i KM nr.639, datë 30.11.2000	Për rritjen e shtesës së vështirësisë në shërbimin e efektivave në kompaninë operative dhe degën e ruajtjes e sigurimit të objekteve, në batalionin e parë, të dytë, të tretë dhe në batalionin special, në Gardën e Republikës	1947
Vendim i KM nr.640, datë 30.11.2000	Për rritjen e pagesës kalimtare të ushtarakëve në rezervë (lirim)	1948
Vendim i Gj.L. nr.1030	Me objekt: Anullimi i vendimit të K.M. nr.44, datë 21.01.1999, pika 7, në pjesën që ka vendosur paditësin person të lidhur me Shoqërinë "Gjallica" sh.p.k	1948
Vendim i Gj.L. nr.1029	Me objekt: Plotësim i vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.643, datë 11.05.2000, në bazë të nenit 313 të Kodit të Procedurës Civile	1952

L I G J
Nr.8689, datë 16.11.2000

PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT HIV/AIDS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Infeksioni HIV/AIDS (ose SIDA) është sëmundja e shkaktuar nga virusi i mangësisë së fituar të imunitetit njerëzor dhe në këtë kuptim "Personat e infektuar nga HIV-i, janë persona të infektuar nga virusi i imunodeficitit njerëzor".

Neni 2

Ky ligj është i detyrueshëm për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, të cilët ndodhen ose janë të regjistruar dhe zhvillojnë veprimtari në Republikën e Shqipërrisë.

Neni 3

Garancitë për të drejtat dhe liritë e personave të infektuar nga HIV-i, si dhe detyrimet e parashikuara në këtë ligj janë të vlefshme edhe për shtetasit e huaj që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Komisioni Kombëtar i luftës kundër HIV/AIDS-it, që funksionon pranë Ministrisë së Shëndetësisë, ka atributet e një Komisioni Kombëtar Ndërministror. Në përbërje të këtij komisioni janë zëvendësministrat e këtyre dikastereve:

Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sporteve, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrisë së Financave, si dhe përfaqësues nga RTSH-ja.

Komisioni Kombëtar Ndërministror i HIV/AIDS-it i propozon Këshillit të Ministrave për marrjen e vendimeve përkatëse për parandalimin dhe luftimin e kësaj sëmundjeje.

Këshilli i Ministrave vendos për detyrat dhe funksionet e këtij Komisioni.

Neni 5

Ministria e Shëndetësisë përcakton, me akte nënligjore, strukturën dhe funksionet e shërbimit shëndetësor për:

a) diagnozën konfirmuese laboratorike të HIV-it pranë qendrave kombëtare të referencës;

b) trajtimin e të sëmurëve në kushte spitalore pranë shërbimeve kombëtare dhe rajonale, sipas standardeve të OBSH-së;

c) trajtimin, këshillimin dhe mbështetjen psikologjike të të sëmurëve ose bartësve të HIV-it në

kushte ambulatore, pranë dispancerive rajonale të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (SST), si dhe kujdesin në shtëpi;

ç) mbikëqyrjen sero-epidemiologjike të përhapjes së infeksionit HIV në territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) regjistrimin, deklarimin dhe raportimin e të sëmurëve me AIDS.

KREU II
ROLI I INSTITUCIONEVE SHTETËRORE

Neni 6

Shteti siguron informim të rregullt për popullsinë, duke përdorur të gjitha format dhe mjetet legale të komunikimit masiv për masat parandaluese të infeksionit HIV.

Neni 7

Ministria e Shëndetësisë përcakton, me akte nënligjore, mënyrat e parandalimit, të diagnostikimit dhe të trajtimit të infeksionit nga HIV-i, si dhe të kontrollit për HIV-in të lëngjeve biologjike dhe të indeve që përdoren me qëllim diagnostik, terapeutik ose shkencor.

Neni 8

Institucionet shëndetësore shtetërore realizojnë ekzaminimin laboratorik falas për zbulimin e infeksionit HIV, me qëllim:

a) diagnostikimin e të sëmurëve të dyshimtë (me emër);

b) studimin sero-epidemiologjik dhe shkencor (anonim i palidhur);

c) kërkim vullnetar (me emër);

ç) kërkim vullnetar (pa emër, me kod);

Tarifat e pagesës vendosen nga Ministria e Shëndetësisë në rastet e ekzaminimit me kërkesë për plotësim dokumentesh shëndetësore.

Neni 9

Çdo person që i nënshtrohet ekzaminimit laboratorik për infeksionin HIV, gëzon të drejtën e kontrollit paraprak në një qendër mjekësore, si dhe të ruajtjes së konfidencialitetit dhe të sekretit mjekësor. Nxjerrja e sekretit mjekësor nga cilido person juridik në fjalë, pa dëshirën e personit të infektuar, dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Shteti mbështet financiarisht zhvillimin e kërkimeve shkencore për problemet që lidhen me infeksionin HIV, përfshirjen në programet pedagogjike të institucioneve arsimore të aspekteve të edukimit moral dhe seksual, zhvillimin e programeve të promocionit dhe të edukimit shëndetësor për formimin e arsimtarëve, të edukatorëve dhe të personelit shëndetësor.

KREU III
PARIME TË NDIHMËS MJEKËSORE

Neni 11

Shteti siguron çdo lloj kujdesi shëndetësor, barnat për mjekimin ambulator ose në spital, si dhe transportin falas të përcaktuar për nevojat e kujdesit mjekësor për qytetarët shqiptarë të sëmurë me HIV/AIDS.

Neni 12

Ekzaminimi mjekësor, specifik për infeksionin HIV, realizohet vetëm në institucionet e sistemit shëndetësor shtetëror të vendit të autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 13

Ekzaminimi mjekësor për HIV-in kryhet vullnetarisht, me përjashtim të rasteve:

a) të parashikuara në ligjin nr.7761, datë 19.10.1993 "Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse", si dhe të ligjit nr.8032, datë 16.11.1996 "Për shërbimin e transfuzionit të gjakut, të produkteve të tij dhe transplantimeve";

b) të pacientëve të shtruar në institucionet shëndetësore për qëllime diagnostikimi.

Neni 14

Çdo person, që i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor për HIV-in, gëzon të drejtën që përfaqësuesi i tij legal të jetë i pranishëm gjatë ekzaminimit. Në rastet kur bëhet fjalë për një fëmijë nën 14 vjeç ose kur personi ligjërisht është i paaftë, ekzaminimi mjekësor mund të kryhet me kërkesën dhe pëlqimin e përfaqësuesve legalë të tyre, të cilët kanë të drejtë të jenë të pranishëm edhe gjatë ekzaminimit mjekësor.

Neni 15

Asnjë dokument i ekzaminimit mjekësor për HIV-in nuk është i detyrueshëm për qytetarët e huaj që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga koha e qëndrimit të tyre.

Neni 16

Çdo person, që i është nënshtruar një ekzaminimi mjekësor për HIV-in, ka të drejtë të kryejë një ekzaminim tjetër që mund të realizohet në të njëjtin laborator ose në një laborator tjetër të autorizuar, sipas dëshirës së tij, pavarësisht nga koha kur e ka kryer ekzaminimin e parë.

KREU IV
E DREJTA E INFORMIMIT TË PERSONIT TË INFEKTUAR ME HIV

Neni 17

Çdo person tek i cili është zbuluar një infeksion nga HIV-i, duhet të vihet në dijeni për rezultatin nga mjeku i ngarkuar pranë dispancerisë së specializuar spitalore, ambulatore ose klinikës ku është kryer këshillimi dhe ekzaminimi mjekësor. Sipas pëlqimit të personit të infektuar, ky rezultat i komunikohet personave të tjerë që ai dëshiron.

Neni 18

Personeli i laboratorit, që kryen ekzaminimin, nuk ka të drejtë t'i tregojë rezultatin pozitiv të infektuarit me HIV ose të afërmve të tij.

Neni 19

Në rast të zbulimit të infeksionit HIV te personat nën 18 vjeç, si dhe te personat me pazotësi juridike, rezultati i ekzaminimit mjekësor u komunikohet të afërmve ose përfaqësuesve ligjorë të të infektuarit.

KREU V
MBËSHTETJA SOCIALE PËR PERSONAT E INFEKTUAR ME HIV

Neni 20

Personat me moshë deri 18 vjeç, të cilët janë infektuar nga HIV-i, kanë të drejtë të përfitojnë një pension ose ndihmë sociale, kur ata janë të paaftë për të punuar.

Neni 21

Janë të ndaluara: pushimi nga puna, mospranimi në punë, mospranimi në një institucion arsimor, shëndetësor, kufizimet e të drejtave të tjera dhe të interesave të ligjshëm, si ajo e banimit dhe në fusha të tjera të jetës, si për personat e infektuar nga HIV-i dhe për anëtarët e familjeve të tyre, duke nxjerrë si shkak infeksionin me HIV/AIDS.

Neni 22

Prindërit, fëmijët e të cilëve janë të infektuar nga HIV-i ose përfaqësuesit legalë të tyre kanë të drejtë:

a) T'u shërbejnë fëmijëve deri në moshën 18 vjeç, në një institucion spitalor, duke zbatuar detyrimet dhe rregullat e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

b) Njëri nga prindërit ose përfaqësuesi legal i një fëmije të infektuar nga HIV-i, me moshë deri 18 vjeç, përfiton udhëtim falas në rast shoqërimi për marrjen e ndihmës mjekësore, deri në institucionin shëndetësor dhe për kthim.

c) Njëri nga prindërit ose përfaqësuesi legal i fëmijës së infektuar nga HIV-i, me moshë deri 18 vjeç, i ruhet vjetërsia në punë për kohën që ai i shërben fëmijës së sëmurë. Kjo periudhë përcaktohet nga institucioni shëndetësor dhe vërtetohet me raport mjekësor.

ç) Prindërit ose përfaqësuesit legalë, që kanë në ngarkim një fëmijë me HIV, me moshë deri në 18 vjeç, kur ai banon me ta, duhet të përfitojnë, në mënyrë parësore nga fondet shtetërore të ndërtimeve, për të përmirësuar kushtet e banimit, kur ato gjykohen të domosdoshme.

Mënyra dhe masa e përfitimeve sipas shkronajve "b", "c" dhe "ç" rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 23

Institucionet shëndetësore publike ose private dëmshpërblejnë personin e infektuar me HIV sipas legjislacionit në fuqi, në rastet kur infektimi është kryer si pasojë e mosrespektimit të rregullave gjatë ushtrimit të detyrës nga personeli mjekësor.

Neni 24

Çdo marrëveshje ndërkombëtare, ku vendi ynë është palë e që përcakton rregulla të tjera të paparashikuara në këtë ligj, merr përparësi.

Neni 25

Ministria e Shëndetësisë përcakton rregullat e mbrojtjes në punë nga infeksioni HIV, si dhe stimulon me pagë punonjësit që merren me diagnozën laboratorike të HIV-it dhe me kujdesin e drejtpërdrejtë të të sëmurëve me AIDS.

Neni 26

Shmangia e personelit mjekësor ndaj diagnozës, kontrollit dhe mjekimit të të sëmurëve me HIV-AIDS, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në vlerën e dy pagave mujore. Kjo masë merret me vendim të titullarit të institucionit përkatës.

Procedurat për vënien e gjobës dhe ankimin rregullohen nga ligji nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 27

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e neneve 4,7,10,22 dhe 25 të këtij ligji.

Neni 28

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2814, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8693, datë 23.11.2000

PËR RATIFIKIMIN E "AMENDAMENTIT TË KONVENTËS FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO CENTRALE - ITALI PËR FINANCIMIN E PËRBËRËSVE TË ASISTENCËS TEKNIKE PËR NDËRMARRJEN E UJËRAVE DHE TË NDËRHYRJEVE INFRASTRUKTURORE NË RRJETIN HIDRIK, NË KUADËR TË PROJEKTIT TË REHABILITIMIT TË RRJETIT HIDRIK TË TIRANËS"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Amendamenti i Konventës Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale - Itali për financimin e përbërësve të asistencës teknike për ndërmarrjen e ujërave dhe të ndërhyrjeve infrastrukturore në rrjetin hidrik, në kuadër të projektit të rehabilitimit të rrjetit hidrik të Tiranës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2818, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

AMENDAMENTI NR.1
NË KONVENTËN FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO CENTRALE – ITALI PËR 53 200 000 000 (PESËDHJETË E TRE MILIARDË E DYQIND MILIONË) LIRA ITALIANE, FIRMOSUR MË 11 MAJ 2000

Nenit 1 të Konventës i shtohen pikat 1.5 dhe 1.6 si vijon:

"1.5 Kontratat në lidhje me projektin e përmendur në pikën 1.2 më lart do të trajtohen sipas procedurave të përzgjedhjes së Bankës Botërore për prokurimin e shërbimeve, të punimeve dhe mallrave, duke mbajtur parasysh specifikën e kredisë italiane.

1.6 Përqindja e "përjashtimit" e pranuar për secilën nga kontratat e pikës më sipër, fiksohet në maksimumin 35 % (tridhjetë e pesë për qind) të vlerës së vetë kontratës."

PËR MEDICREDITO CENTRALE – ITALI	PËR QEVERINË E REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
Romë, 22.9.2000	Ministri i Financave

L I G J
Nr.8694, datë 23.11.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES PËR KONSOLIDIMIN E BORXHIT TË JASHTËM TË SHQIPËRISË, NË BAZË TË TERMAVE TË REFERENCËS SË KLUBIT TË PARISIT, TË 22 KORRIKUT 1998, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e konsolidimit të borxhit të jashtëm të Shqipërisë, në bazë të termave të referencës së Klubit të Parisit, të 22 korrikut 1998, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2819, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

TERMAT E REFERENCËS
MBI REDUKTIMIN DHE RIORGANIZIMIN E BORXHIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I –A/ HYRJE

Përfaqësuesit e Qeverive të Italisë dhe Federatës Ruse, referuar më poshtë si "Vende Kreditore Pjesëmarrëse", u takuan në Paris në 22 Korrik 1998. Vëzhgues nga Qeveritë e Australisë, Austrisë, Belgjikës, Kanadasë, Danimarkës, Francës, Gjermanisë, Japonisë, Holandës, Norvegjisë, Spanjës, Suedisë, Zvicrës dhe Britanisë së Madhe e SHBA gjithashtu ndoqën takimin.

Përfaqësuesit e Qeverive të Vendeve Kreditore Pjesëmarrëse, vunë në dukje masat e forta ekonomike dhe financiare në programin e rimëkëmbjes të ndërmarrë nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe të mbështetura nga ESAF, e aprovuar nga Bordi Ekzekutiv i FMN në 13 Maj 1998. Ata theksuan rëndësinë, që i japin implementimit të plotë dhe të vazhduar të këtij programi dhe në veçanti rivitalizimit të sektorit prodhues të ekonomisë dhe përmirësimit të financës publike dhe menaxhimit të këmbimit valutor.

Ata mbajtën parasysh problemet e bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë dhe detyrimet e rënda të borxhit, si dhe të ardhurat e ulëta për frymë, të cilat u konsideruan se kërkojnë trajtim të veçantë të borxhit duke marrë në konsideratë programin ristrukturues të përmendur më sipër.

B/PËRKUFIZIME

1. Për qëllimet e Termave të tanishme të Referencës, "Kursi i Përshtatshëm i Tregut", nënkupton kursin e rrumbullakosur deri në 1/16 e një pike, dhe kushtet e interesit, të cilat do të caktohen bashkarisht midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë ose institucioneve përkatëse të çdo Vendi Kreditor Pjesëmarrës.

2. Tabelat e vërtetuara bashkëngjitur termave të referencës dhe referuar më poshtë, si pjesë integrale e Termave të Referencës. Siç përmendet në skemat e ripagimit të treguara në Tabelat A1 dhe A2, kuptohet që semester nënkupton një periudhë prej 6 muajsh të njëpasnjëshëm. Semestri i parë referuar në Tabela është periudha që fillon në 1 Nëntor 1998. Për çdo semester kuptohet, që data e detyruar është data e parë e semestrit korrespondues.

3. Kamata për vonesën e interesit është ajo pagesë e interesit që rrjedh midis datës kontraktuale të pagesës së interesit dhe që nuk është paguar dhe një date që do të fiksohet në marrëveshjet bilaterale që do të përfundohen për implementimin e termave të tanishëm të referencës.

II – REKOMANDIME MBI TERMAT E RIORGANIZIMIT

Duke mbajtur parasysh vështirësitë serioze të pagesave që po has Republika e Shqipërisë, përfaqësuesit e Vendeve Kreditore Pjesëmarrëse ranë dakord t'i rekomandojnë Qeverive të tyre ose institucioneve përkatëse që ata t'i sigurojnë nëpërmjet riskedulimit ose rifinancimit Republikës së Shqipërisë lehtësim të borxhit me termat e mëposhtme:

1. Borxhet që do të përfshihen

Borxhet për të cilat do të bëhet ky riorganizim, janë si më poshtë:

a) kreditë komerciale të garantuara ose siguruara nga Qeveritë e Vendeve Kreditore Pjesëmarrëse ose institucioneve të tyre përkatëse, duke pasur maturitet fillestar më shumë se 1 vit dhe që i janë dhënë Qeverisë së RSH ose institucioneve të saj përkatëse, në bazë të një marrëveshjeje të përfunduar para 30 Shtatorit 1993;

b) hua nga qeveritë ose institucionet përkatëse të vendeve Kreditore duke pasur maturitet më shumë se 1 vit dhe që i janë dhënë Qeverisë së RSH ose institucioneve të saj, ose janë mbuluar nga

garancia e RSH ose institucioneve të saj përkatëse, në bazë të një marrëveshjeje, që është përfunduar përpara 30 Shtatorit 1993.

Kuptohet që shërbimi i borxhit, i detyruar si rezultat i borxheve të përshkruara më lart në këto terma të referencës dhe i kryer nëpërmjet mekanizmave të pagesës speciale ose llogarive të tjera të jashtme përfshihet në riorganizimin e tanishëm. Vendet Kreditore Pjesëmarrëse do të rakordojnë dhe rifinancojnë ose do të marrin masa të tjera të përshtatshme për të siguruar që kjo kategori e borxhit të trajtohet në mënyrë të krahasueshme me subjekte të tjera të Termave të Referencës.

Kuptohet që shërbimi i borxhit, i detyruar si rezultat i marrëveshjeve mbi konsolidimin të përfunduara sipas termave të referencës të datës 15 Dhjetor 1993 nuk preken nga riorganizimi i tanishëm.

2. Termat e konsolidimit

Lehtësitë e borxhit do të aplikohen si vijon:

a) 100% për shumat e principalit dhe interesit (duke përfshirë interes-vonesën) të detyruara deri në 30 Prill 1998 dhe të papaguara do të riskedulohen ose financohen.

Ripagimi nga Qeveria e RSH të shumave korresponduese do të bëhen siç përshkruhen në Tabelën A1 të bashkangjitur Termave të Referencës.

Të gjithë shumat e tjera të detyruara nga 1 Maj 1998 e më tej mbi kreditë ose huatë e përmendura në paragrafet 1 a) dhe 1 b) më sipër do të paguhen nga Qeveria e RSH sipas kushteve fillestare kontraktuale.

b) kurset dhe kushtet e interesit mbi masat e rakordimit dhe financimit të mbuluara nga paragrafi a) më sipër do të caktohen bashkarisht midis Qeverisë së RSH dhe Qeverisë ose institucionit përkatës të Vendeve Kreditore Pjesëmarrëse në bazë të kursit përkatës të tregut dhe reduktimi neto i vlerës për t'u arritur në çdo kategori të borxheve si parashikohet në paragrafin c) më poshtë, në bazë të tabelës A2 bashkangjitur Termave të Referencës;

c) reduktimi neto i vlerës për t'u arritur është 50% mbi kreditë dhe huatë e përmendura në paragrafet 1.a) dhe 1.b) dhe 2.B/a) më sipër.

III – REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

1. Me qëllim që të sigurojë trajtim të krahasueshëm të borxhit ndaj gjithë kreditorëve privatë ose publikë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë vetangazhohet të negociojë menjëherë për rregullimet mbi uljen e borxhit me gjithë kreditorët e jashtëm.

Për rrjedhojë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë vetangazhohet të mos i akordojë ndonjë kategorie kreditorësh dhe në veçanti vendeve kreditore, të cilat nuk marrin pjesë në termat aktuale të referencës, bankave komerciale dhe furnitorëve një trajtim më të favorshëm se sa ai, që Vendet Kreditore Pjesëmarrëse kanë akorduar për kreditë me maturitet të krahasueshëm dhe natyrë legale.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të informojë Kryetarin e Klubit të Parisit me shkrim, jo më vonë se 31 Dhjetori 1998, për statusin e negociatave dhe kontekstin e marrëveshjeve bilaterale me kreditorët. Pastaj, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të vazhdojë të informojë rregullisht me shkrim Kryetarin e Klubit të Parisit për statusin e negociatave me kreditorët e tjerë, si dhe për pagesat e bëra atyre.

3. Klauzolat e parashtruara në këto Terma reference nuk zbatohen për vendet kreditore, të cilave afati i pagesës së principalit dhe interesit, u takon gjatë periudhës së riorganizimit së borxhit të specifikuar në Artikullin II, paragrafi 2, për më pak se 150000 SDR. Pagesat për këto vende duhen bërë në datat e tyre origjinale. Pagesat të cilave u ka kaluar afati dhe nuk janë bërë duhet të bëhen sa më shpejt të jetë e mundur dhe, në asnjë rast, pas 1 Tetorit 1998. Mbi këto shuma do të llogaritet interesi.

4. Secili prej Vendeve Kreditore Pjesëmarrëse bie dakord, që sipas kërkesës së një tjetër Vendi Kreditor Pjesëmarrës t'i vërë këtij në dispozicion një kopje të marrëveshjes bilaterale me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, në të cilën gjejnë zbatim Termat aktualë të referencës. Qeveria e Republikës së Shqipërisë e pranon këtë aranxhim.

5. Secili prej Vendeve Kreditore Pjesëmarrëse bie dakord të informojë Kryetarin e Klubit të Parisit për datën e nënshkrimit të marrëveshjes së tij bilaterale, për format e interesit dhe shumat e borxheve të angazhuara. Qeveria e Republikës së Shqipërisë e pranon këtë aranxhim.

6. Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet të paguajë për gjithë shërbimin e borxhit të

përcaktuar dhe të pashlyer në datën e caktuar në Termat e Referencës mbi konsolidimin, mbi huatë, mbi kreditë apo në pajtim me kontratat ose marrëveshjeve të tjera financiare të pagueshme në cash, të cilave u është shtyrë afati ose është lëshuar garanci nga Qeveritë e Vendeve Pjesëmarrëse apo vendeve Kreditore Observuese ose nga institucionet e tyre përkatëse, dhe që nuk janë mbuluar me shpejtësi nga Termat e referencës, por në çdo rast jo më vonë se 1 Tetori 1998.

Interesi i vonuar do të ngarkohet mbi këto shuma.

IV - ZBATIMI

Marrëveshjet e detajuara për riskedulimin ose rifinancimin e borxheve do të shoqërohen me marrëveshje bilaterale për të cilat mbi bazën e parimeve të mëposhtme, do të konkludohet nga Qeveria apo nga institucionet përkatëse të çdo Vendi Kreditor Pjesëmarrës me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë:

1. Qeveria ose institucionet përkatëse të çdo Vendi Kreditor Pjesëmarrës do të:

- rifinancojnë borxhet duke vendosur fonde të reja në dispozicion të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, sipas grafikëve ekzistues të pagesave, gjatë periudhës së riorganizimit dhe për përqindjet e sipërpërmendura të pagesave. Këto fonde do të ripaguhen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë sipas termave dhe kushteve të parashtruara në Artikullin II, paragrafi 2 të mësipërm;
- dhe riskedulojë pagesat korresponduese.

2. Gjithë çështjet e tjera të përfshira në riskedulimin apo rifinancimin e këtyre borxheve do të parashikohen në marrëveshjet bilaterale, të cilat Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveritë ose institucionet përkatëse të Vendeve Kreditore Pjesëmarrëse do të kërkojnë të përfundojnë pa vonesë dhe në çdo rast jo më vonë se 31 Tetori 1998.

3. Përfaqësuesit e Qeverive të çdo vendi Kreditor Pjesëmarrës dhe të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë bien dakord t'i rekomandojnë qeverive të tyre respektive apo institucioneve përkatëse se ata do t'i fillojnë negociatat bilaterale në rastin më të parë dhe do t'i përçojnë ato mbi bazën e parimeve të parashtruara këtu.

TABELA A1

Mundësia e pakësimit të Shërbimit të Borxhit
Maturimi 50%

Skeduli i Ripagesës

Viti	**Semestri**	**Këstet e Principalit (në %)**
	1	0.85
1	2	0.89
	3	0.94
2	4	0.98
	5	1.02
3	6	1.07
	7	1.11
4	8	1.16
	9	1.21
5	10	1.26
	11	1.31
6	12	1.36
	13	1.41
7	14	1.47

	15	1.52
8	16	1.58
	17	1.64
9	18	1.7
	19	1.76
10	20	1.82
	21	1.88
11	22	1.95
	23	2.01
12	24	2.08
	25	2.15
13	26	2,22
	27	2,29
14	28	2.36
	29	2.44
15	30	2.51
	31	2.59
16	32	2.67
	33	2.75
17	34	2.84
	35	2.92
18	36	3
	37	3.1
19	38	3.19
	39	3.29
20	40	3.37
	41	3.47
21	42	3.57
	43	3.67
22	44	3.77
	45	3.87
23	46	3.99

TABELA A2

VARIANTI I REDUKTIMIT TE BORXHIT
MATURIMET 50%

Perqindja e interesit e reduktuar qe do te aplikohet

Perqindja e tregut	*Reduktimi ne vleren neto te te tanishme* 25%	50%
0.0625%	0.1000%	0.1000%
0.1250%	0.1000%	0.1000%
0.1875%	0.1000%	0.1000%
0.2500%	0.1000%	0.1000%
0.3125%	0.1000%	0.1000%
0.3750%	0.1000%	0.1000%
0.4375%	0.1000%	0.1000%
0.5000%	0.1000%	0.1000%
0.5625%	0.1000%	0.1000%
0.6250%	0.1000%	0.1000%
0.6875%	0.1000%	0.1000%
0.7500%	0.1000%	0.1000%
0.8125%	0.1000%	0.1000%
0.8750%	0.1000%	0.1000%
0.9375%	0.1000%	0.1000%
1.0000%	0.1000%	0.1000%
1.0625%	0.1000%	0.1000%
1.1250%	0.1000%	0.1000%
1.1875%	0.1000%	0.1000%
1.2500%	0.1000%	0.1000%
1.3125%	0.1000%	0.1000%
1.3750%	0.1000%	0.1000%
1.4375%	0.1000%	0.1000%
1.5000%	0.1000%	0.1000%
1.5625%	0.1000%	0.1000%
1.6250%	0.1000%	0.1000%
1.6875%	0.1000%	0.1000%
1.7500%	0.1000%	0.1000%
1.8125%	0.1000%	0.1000%
1.8750%	0.1000%	0.1000%
1.9375%	0.1000%	0.1000%
2.0000%	0.1000%	0.1000%
2.0625%	0.1000%	0.1000%
2.1250%	0.1000%	0.1000%
2.1875%	0.1184%	0.1000%
2.2500%	0.1704%	0.1000%
2.3125%	0.2224%	0.1000%
2.3750%	0.2745%	0.1000%
2.4375%	0.3264%	0.1000%
2.5000%	0.3784%	0.1000%
2.5625%	0.4303%	0.1000%
2.6250%	0.4822%	0.1000%
2.6875%	0.5341%	0.1000%
2.7500%	0.5860%	0.1000%
2.8125%	0.6378%	0.1000%
2.8750%	0.6896%	0.1000%
2.9375%	0.7414%	0.1000%
3.0000%	0.7931%	0.1000%
3.0625%	0.8449%	0.1000%
3.1250%	0.8966%	0.1000%
3.1875%	0.9483%	0.1000%
3.2500%	0.9999%	0.1000%
3.3125%	1.0516%	0.1000%
3.3750%	1.1032%	0.1000%
3.4375%	1.1548%	0.1000%
3.5000%	1.2063%	0.1000%

Perqindja e interesit e reduktuar qe do te aplikohet

Perqindja e tregut	*Reduktimi ne vleren neto te tanishme* 25%	50%
3.5625%	1.2579%	0.1000%
3.6250%	1.3094%	0.1000%
3.6875%	1.3609%	0.1000%
3.7500%	1.4124%	0.1000%
3.8125%	1.4638%	0.1000%
3.8750%	1.5152%	0.1000%
3.9375%	1.5666%	0.1000%
4.0000%	1.6180%	0.1000%
4.0625%	1.6694%	0.1000%
4.1250%	1.7207%	0.1000%
4.1875%	1.7720%	0.1000%
4.2500%	1.8233%	0.1000%
4.3125%	1.8746%	0.1000%
4.3750%	1.9258%	0.1000%
4.4375%	1.9771%	0.1000%
4.5000%	2.0283%	0.1000%
4.5625%	2.0794%	0.1000%
4.6250%	2.1306%	0.1000%
4.6875%	2.1817%	0.1000%
4.7500%	2.2328%	0.1000%
4.8125%	2.2839%	0.1000%
4.8750%	2.3350%	0.1000%
4.9375%	2.3860%	0.1000%
5.0000%	2.4371%	0.1000%
5.0625%	2.4881%	0.1000%
5.1250%	2.5391%	0.1000%
5.1875%	2.5900%	0.1000%
5.2500%	2.6410%	0.1000%
5.3125%	2.6919%	0.1000%
5.3750%	2.7428%	0.1106%
5.4375%	2.7937%	0.1498%
5.5000%	2.8445%	0.1890%
5.5625%	2.8953%	0.2282%
5.6250%	2.9462%	0.2673%
5.6875%	2.9970%	0.3064%
5.7500%	3.0477%	0.3455%
5.8125%	3.0985%	0.3845%
5.8750%	3.1492%	0.4234%
5.9375%	3.1999%	0.4624%
6.0000%	3.2506%	0.5012%
6.0625%	3.3013%	0.5401%
6.1250%	3.3519%	0.5789%
6.1875%	3.4026%	0.6176%
6.2500%	3.4532%	0.6564%
6.3125%	3.5038%	0.6951%
6.3750%	3.5544%	0.7337%
6.4375%	3.6049%	0.7723%
6.5000%	3.6554%	0.8109%
6.5625%	3.7060%	0.8494%
6.6250%	3.7564%	0.8879%
6.6875%	3.8069%	0.9263%
6.7500%	3.8574%	0.9648%
6.8125%	3.9078%	1.0031%
6.8750%	3.9582%	1.0415%
6.9375%	4.0086%	1.0798%
7.0000%	4.0590%	1.1180%

TABELA A2

VARIANTI I REDUKTIMIT TE BORXHIT
MATURIMET 50%

Perqindja e interesit e reduktuar qe do te aplikohet

Perqindja e tregut	*Reduktimi ne vleren neto te tanishme* 25%	50%
7.0625%	4.2094%	1.1563%
7.1250%	4.1597%	1.1944%
7.1875%	4.2100%	1.2326%
7.2500%	4.2604%	1.2707%
7.3125%	4.3106%	1.3088%
7.3750%	4.3609%	1.3468%
7.4375%	4.4112%	1.3848%
7.5000%	4.4614%	1.4228%
7.5625%	4.5116%	1.4607%
7.6250%	4.5618%	1.4986%
7.6875%	4.6120%	1.5365%
7.7500%	4.6622%	1.5743%
7.8125%	4.7123%	1.6121%
7.8750%	4.7624%	1.6498%
7.9375%	4.8125%	1.6876%
8.0000%	4.8626%	1.7252%
8.0625%	4.9127%	1.7629%
8.1250%	4.9628%	1.8005%
8.1875%	5.0128%	1.8381%
8.2500%	5.0628%	1.8756%
8.3125%	5.1128%	1.9131%
8.3750%	5.1628%	1.9506%
8.4375%	5.2128%	1.9881%
8.5000%	5.2627%	2.0255%
8.5625%	5.3127%	2.0629%
8.6250%	5.3626%	2.1002%
8.6875%	5.4125%	2.1375%
8.7500%	5.4624%	2.1748%
8.8125%	5.5123%	2.2120%
8.8750%	5.5621%	2.2492%
8.9375%	5.6120%	2.2864%
9.0000%	5.6618%	2.3236%
9.0625%	5.7116%	2.3607%
9.1250%	5.7614%	2.3978%
9.1875%	5.8112%	2.4348%
9.2500%	5.8609%	2.4718%
9.3125%	5.9107%	2.5088%
9.3750%	5.9604%	2.5458%
9.4375%	6.0101%	2.5827%
9.5000%	6.0598%	2.6196%
9.5625%	6.1095%	2.6565%
9.6250%	6.1592%	2.6933%
9.6875%	6.2088%	2.7301%
9.7500%	6.2584%	2.7669%
9.8125%	6.3081%	2.8036%
9.8750%	6.3577%	2.8403%
9.9375%	6.4073%	2.8770%
10.0000%	6.4568%	2.9137%
10.0625%	6.5064%	2.9503%
10.1250%	6.5559%	2.9869%
10.1875%	6.6055%	3.0234%
10.2500%	6.6550%	3.0600%
10.3125%	6.7045%	3.0965%
10.3750%	6.7540%	3.1330%
10.4375%	6.8035%	3.1694%
10.5000%	6.8529%	3.2058%

Perqindja e interesit e reduktuar qe do te aplikohet

Perqindja e tregut	*Reduktimi ne vleren neto te tanishme* 25%	50%
10.5625%	6.9024%	3.2422%
10.6250%	6.9518%	3.2786%
10.6875%	7.0012%	3.3149%
10.7500%	7.0506%	3.3512%
10.8125%	7.1000%	3.3875%
10.8750%	7.1494%	3.4238%
10.9375%	7.1987%	3.4600%
11.0000%	7.2481%	3.4962%
11.0625%	7.2974%	3.5323%
11.1250%	7.3467%	3.5685%
11.1875%	7.3960%	3.6046%
11.2500%	7.4453%	3.6407%
11.3125%	7.4946%	3.6767%
11.3750%	7.5439%	3.7128%
11.4375%	7.5931%	3.7488%
11.5000%	7.6424%	3.7848%
11.5625%	7.6916%	3.8207%
11.6250%	7.7408%	3.8567%
11.6875%	7.7900%	3.8926%
11.7500%	7.8392%	3.9284%
11.8125%	7.7884%	3.9643%
11.8750%	7.9376%	4.0001%
11.9375%	7.9867%	4.0359%
12.0000%	8.0359%	4.0717%
12.0625%	8.0850%	4.1075%
12.1250%	8.1341%	4.1432%
12.1875%	8.1832%	4.1789%
12.2500%	8.2323%	4.2146%
12.3125%	8.2814%	4.2502%
12.3750%	8.3304%	4.2859%
12.4375%	8.3795%	4.3215%
12.5000%	8.4285%	4.3570%
12.5625%	8.4776%	4.3926%
12.6250%	8.5266%	4.4281%
12.6875%	8.5756%	4.4636%
12.7500%	8.6246%	4.4991%
12.8125%	8.6735%	4.5346%
12.8750%	8.7225%	4.5700%
12.9375%	8.7715%	4.6055%
13.0000%	8.8204%	4.6408%
13.0625%	8.8694%	4.6762%
13.1250%	8.9183%	4.7116%
13.1875%	8.9672%	4.7469%
13.2500%	9.0161%	4.7822%
13.3125%	9.0650%	4.8175%
13.3750%	9.1139%	4.8527%
13.4375%	9.1627%	4.8880%
13.5000%	9.2116%	4.9232%
13.5625%	9.2604%	4.9584%
13.6250%	9.3093%	4.9936%
13.6875%	9.3581%	5.0287%
13.7500%	9.4069%	5.0638%
13.8125%	9.4557%	5.0989%
13.8750%	9.5045%	5.1340%
13.9375%	9.5533%	5.1691%
14.0000%	9.6021%	5.2041%

TABELA A2

VARIANTI I REDUKTIMIT TE BORXHIT
MATURIMET 50%

Perqindja e interesit e reduktuar qe do te aplikohet

Perqindja e tregut	*Reduktimi ne vleren neto te te tanishme* 25%	50%
14.0625%	9.6508%	5.2392%
14.1250%	9.6996%	5.2742%
14.1875%	9.7483%	5.3091%
14.2500%	9.7971%	5.3441%
14.3125%	9.8458%	5.3790%
14.3750%	9.8945%	5.4140%
14.4375%	9.9432%	5.4489%
14.5000%	9.9919%	5.4837%
14.5625%	10.0406%	5.5186%
14.6250%	10.0892%	5.5534%
14.6875%	10.1379%	5.5883%
14.7500%	10.1865%	5.6231%
14.8125%	10.2352%	5.6578%
14.8750%	10.2838%	5.6926%
14.9375%	10.3324%	5.7274%
15.0000%	10.3810%	5.7621%
15.0625%	10.4296%	5.7968%
15.1250%	10.4782%	5.8315%
15.1875%	10.5268%	5.8661%
15.2500%	10.5754%	5.9008%
15.3125%	10.6240%	5.9354%
15.3750%	10.6725%	5.9700%
15.4375%	10.7211%	6.0046%
15.5000%	10.7696%	6.0392%
15.5625%	10.8181%	6.0737%
15.6250%	10.8666%	6.1083%
15.6875%	10.9152%	6.1428%
15.7500%	10.9637%	6.1773%
15.8125%	11.0121%	6.2118%
15.8750%	11.0606%	6.2463%
15.9375%	11.1091%	6.2807%
16.0000%	11.1576%	6.3151%
16.0625%	11.2060%	6.3496%
16.1250%	11.2545%	6.3839%
16.1875%	11.3029%	6.4183%
16.2500%	11.3513%	6.4527%
16.3125%	11.3998%	6.4870%
16.3750%	11.4482%	6.5214%
16.4375%	11.4966%	6.5557%
16.5000%	11.5450%	6.5900%
16.5625%	11.5934%	6.6243%
16.6250%	11.6418%	6.6585%
16.6875%	11.6901%	6.6928%
16.7500%	11.7385%	6.7270%
16.8125%	11.7869%	6.7612%
16.8750%	11.8352%	6.7954%
16.9375%	11.8835%	6.8296%
17.0000%	11.9319%	6.8638%
17.0625%	11.9802%	6.8979%
17.1250%	12.0285%	6.9320%
17.1875%	12.0768%	6.9662%
17.2500%	12.1251%	7.0003%
17.3125%	12.1734%	7.0344%
17.3750%	12.2217%	7.0684%
17.4375%	12.2700%	7.1025%
17.5000%	12.3183%	7.1365%

Perqindja e interesit e reduktuar qe do te aplikohet

Perqindja e tregut	*Reduktimi ne vleren neto te te tanishme* 25%	50%
17.5625%	12.3665%	7.1706%
17.6250%	12.4148%	7.2046%
17.6875%	12.4630%	7.2386%
17.7500%	12.5113%	7.2725%
17.8125%	12.5595%	7.3065%
17.8750%	12.6077%	7.3405%
17.9375%	12.6560%	7.3744%
18.0000%	12.7042%	7.4083%
18.0625%	12.7524%	7.4422%
18.1250%	12.8006%	7.4761%
18.1875%	12.8488%	7.5100%
18.2500%	12.8969%	7.5439%
18.3125%	12.9451%	7.5777%
18.3750%	12.9933%	7.6116%
18.4375%	13.0415%	7.6454%
18.5000%	13.0896%	7.6792%
18.5625%	13.1378%	7.7130%
18.6250%	13.1859%	7.7468%
18.6875%	13.2340%	7.7806%
18.7500%	13.2822%	7.8143%
18.8125%	13.3303%	7.8481%
18.8750%	13.3784%	7.8818%
18.9375%	13.4265%	7.9155%
19.0000%	13.4746%	7.9492%
19.0625%	13.5227%	7.9829%
19.1250%	13.5708%	8.0166%
19.1875%	13.6189%	8.0503%
19.2500%	13.6670%	8.0839%
19.3125%	13.7150%	8.1176%
19.3750%	13.7631%	8.1512%
19.4375%	13.8112%	8.1848%
19.5000%	13.8592%	8.2184%
19.5625%	13.9073%	8.2520%
19.6250%	13.9553%	8.2856%
19.6875%	14.0033%	8.3191%
19.7500%	14.0514%	8.3527%
19.8125%	14.0994%	8.3862%
19.8750%	14.1474%	8.4198%
19.9375%	14.1954%	8.4533%
20.0000%	14.2434%	8.4868%

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE PËR KONSOLIDIMIN E BORXHIT TË JASHTËM TË SHQIPËRISË SIPAS TERMAVE TË REFERENCËS SË KLUBIT TË PARISIT

MË 22 KORRIK 1998

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane, në frymën e miqësisë dhe bashkëveprimit ekonomik, që ekziston midis dy vendeve dhe në zbatim të "termave të referencës", të Klubit të Parisit më 22 Korrik 1998 për ristrukturimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë, ranë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i kësaj marrëveshjeje është konsolidimi:

a) I borxheve, për kapitale dhe interesa kontraktore, të pashlyera në datën 30 Prill 1998 duke iu referuar kredive tregtare dhe financiare me afat më shumë se një vit dhënë Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, ose institucioneve të saj përkatëse ose të garantuara nga ajo, rrjedhojë e kontratave ose marrëveshjeve financiare të përfunduara para 30 Shtatorit 1993, të ndihmuar nga garanci siguruese të Shtetit Italian nëpërmjet Institutit të Shërbimeve të Sigurimeve të Tregtisë së Jashtme (më poshtë do ta quajmë "SACE" – shkurtim).

b) I interesave vonesë mbi borxhet e përfshira në paragrafin e mësipërm a), të llogaritura nga data e mbarimit të secilës deri më 30 Prill 1998, bashkë me taksat e interesit të treguara në nenin e mëposhtëm III.

Borxhet në fjalë janë pasqyruar në dokumentet bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje. Shumat e listuara mund të ndryshohen në marrëveshje të përbashkëta midis palëve.

Neni 2

Borxhet e përmendura në nenin e mësipërm 1, do të rimbursohen dhe do të kthehen në valutën e caktuar në kontratat ose në marrëveshjet financiare respektive, nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë (më poshtë e quajtur "QEVERIA" tek "SACE" në këtë mënyrë:

1.05.2000	3.66
1.11.2000	1.02
1.05.2001	1.07
1.11.2001	1.11
1.05.2002	1.16
1.11.2002	1.21
1.05.2003	1.26
1.11.2003	1.31
1.05.2004	1.36
1.11.2004	1.41
1.05.2005	1.47
1.11.2005	1.52
1.05.2006	1.58
1.11.2006	1.64
1.05.2007	1.70
1.11.2007	1.76
1.05.2008	1.82
1.11.2008	1.88
1.05.2009	1.95
1.11.2009	2.01
1.05.2010	2.08

1.11.2010	2.15
1.05.2011	2.22
1.11.2011	2.29
1.05.2012	2.36
1.11.2012	2.44
1.05. 2013	2.51
1.11.2013	2.59
1.05.2014	2.67
1.11.2014	2.75
1.05.2015	2.84
1.11.2015	2.92
1.05.2016	3.00
1.11.2016	3.10
1.05.2017	3.19
1.11.2017	3.28
1.05.2018	3.37
1.11.2018	3.47
1.05.2019	3.57
1.11.2019	3.67
1.05.2020	3.77
1.11.2020	3.87
1.05.2021	3.99

Neni 3

Mbi shumicën e borxheve të ristrukturuara në bazë të kësaj marrëveshjeje, Qeveria do t'i paguajë dhe kthejë interesat SACE-s, duke u nisur nga data 1 Maj 1998 deri në datën e rregullimit total të këtyre borxheve, të llogaritura me përqindjen e interesit 0.18% në vit dhe 0.10% në vit respektivisht për borxhet në dollarë amerikanë dhe në lireta (tani Euro). Të tilla interesa do të rregullohen në valutën e treguar në kontrata ose vendime financiare në këste 6-mujore (1 Maj – 1 Nëntor), nga të cilat e para skadon në 1.11.2000.

Neni 4

Për një vonesë të mundshme, më shumë se 30 ditë në pagesat që te nenet 2 dhe 3 të mësipërm, në bazë të datave të parashikuara, Qeveria merr përsipër të rregullojë me gatishmëri SACE-s interesat e vonesave të rregullimit të llogaritura si më poshtë:

- për borxhet në dollarë amerikanë, në bazë të Libor të kuotuar për 6 muaj në datën e skadencës plus 0.5 % në vit.
- për borxhet në lireta (tani Euro), në bazë të Euribor të kuotuar për 6 muaj në datën e skadencës plus 0.5 % në vit.

Neni 5

Me përjashtim të sa është parashikuar në këtë marrëveshje, mbeten të paprekura lidhjet juridike të vendosura nga e drejta e përbashkët dhe detyrimet kontraktuale të ndërmarra nga palët për veprimet që i referohen borxheve të mësipërme te neni 1 të po kësaj marrëveshje.

Neni 6

Kjo marrëveshje hyn në fuqi datën e marrjes së vendimit të fundit, në të cilin të dy palët do të njoftojnë zyrtarisht mbylljen e procedurave të brendshme të parashikuara nga rregulloret përkatëse.

Në mirëbesim, Përfaqësuesit nënshkrues të autorizuar firmosën rregullisht këtë marrëveshje.

Kryer në Tiranë, më 12.10.2000 në dy kopje origjinale në gjuhën italiane dhe shqipe dhe që të dyja me të njëjtën fuqi ligjore.

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS ITALIANE

L I G J
Nr.8696, datë 23.11.2000

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E VJENËS "PËR TË DREJTËN E TRAKTATEVE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Vjenës "Për të drejtën e traktateve".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2821, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTA E VJENËS PËR TË DREJTËN E TRAKTATEVE

Shtetet Palë në këtë Konventë

Duke vlerësuar rolin themelor të traktateve në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare,

Duke njohur rëndësinë në rritje të traktateve si një burim i së drejtës ndërkombëtare dhe si një mjet i zhvillimit paqësor të bashkëpunimit midis kombeve, pavarësisht nga sistemet e tyre sociale dhe kushtetuese,

Duke theksuar se parimet e pëlqimit të lirë dhe të mirëbesimit dhe rregulli pacta sunt servanta janë të njohura universalisht,

Duke pohuar se konfliktet që lidhen me traktatet, ashtu si edhe tërë konfliktet e tjera ndërkombëtare, duhet të zgjidhen me anë të mjeteve paqësore dhe në pajtim me parimet e drejtësisë dhe të së drejtës ndërkombëtare,

Duke kujtuar vendosmërinë e popujve të Kombeve të Bashkuara për të krijuar kushtet sipas të cilave mund të ruhet drejtësia dhe respekti për detyrimet që rrjedhin nga traktatet,

Duke mbajtur parasysh parimet e së drejtës ndërkombëtare të mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara, si parimet e të drejtave të barabarta dhe të vetëvendosjes së popujve, barazisë së sovranitetit dhe të pavarësisë së të gjithë shteteve, të mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve, të ndalimit të kërcënimit ose të përdorimit të forcës dhe të respektimit e mbrojtjes universiale të të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë,

Duke besuar se kodifikimi dhe zhvillimi progresiv i së drejtës së traktateve i arritur në këtë

Konventë do të mbështesë qëllimet e Kombeve të Bashkuara të paraqitura në kartë, dhe pikërisht, ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare dhe zhvillimin e marrëdhënieve miqësore dhe arritjen e bashkëpunimit midis kombeve,

Duke pohuar që rregullat e së drejtës zakonore ndërkombëtare do të vazhdojnë të drejtojnë çështjet e parregulluara nga dispozitat e kësaj Konvente,

Kanë rënë dakord për sa më poshtë :

PJESA I
HYRJE

Neni 1
Fusha e veprimit të kësaj Konvente

Kjo Konventë zbatohet në traktatet midis Shteteve.

Neni 2
Përdorimi i termave

Për qëllimet e kësaj Konvente :

(a) "traktat" nënkupton një marrëveshje ndërkombëtare të përfunduar midis Shteteve në formë shkresore dhe të udhëhequr nga e drejta ndërkombëtare, i cili, pavarësisht nga emërtimi i tij i veçantë, është i materializuar në një dokument të vetëm apo dy ose më shumë dokumente që lidhen me njëri-tjetrin

(b) "ratifikim", "pranim", "miratim" dhe "aderim" nënkupton në çdo rast aktin ndërkombëtar të emërtuar kështu me anën e të cilit një Shtet paraqet në planin ndërkombëtar pëlqimin e tij për të qenë i lidhur nga një traktat;

(c) "fuqi të plota" nënkupton një dokument që rrjedh nga një autoritet kompetent i një Shteti dhe që emëron një ose disa persona të cilët përfaqësojnë Shtetin në zhvillimin e bisedimeve, miratimin ose sigurimin e tekstit të një traktati, për të shprehur pëlqimin e një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat, ose për të përfunduar çdo akt tjetër që lidhet me një traktat;

(d) "rezervë" nënkupton një deklaratë të njëanshme, pavarësisht se si është shprehur apo emërtuar, e bërë nga një Shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit të një traktati, me anën e të cilit ai synon të përjashtojë ose modifikojë efektet ligjore të dispozitave të caktuara të traktatit në zbatimin e tyre në atë Shtet;

(e) "Shtet pjesëmarrës në bisedime" nënkupton një Shtet, i cili ka marrë pjesë në përpilimin dhe miratimin e tekstit të një traktati;

(f) "Shtet kontraktues" nënkupton një Shtet, i cili ka dhënë pëlqimin për të qenë i lidhur nga një traktat, pavarësisht nëse traktati ka hyrë në fuqi ose jo;

(g) "palë" nënkupton një Shtet i cili ka dhënë pëlqimin për të qenë i lidhur nga traktati dhe për të cilën traktati është në fuqi;

(h) "Shtet i tretë" nënkupton një Shtet që nuk është palë në traktat;

(i) "organizatë ndërkombëtare" nënkupton një organizatë ndërqeveritare.

2. Dispozitat e paragrafit 1 në lidhje me përdorimin e termave në këtë Konventë nuk cenojnë përdorimin e tyre ose kuptimet që mund t'u jepen atyre nga ligji i brendshëm i çdo Shteti.

Neni 3
Marrëveshjet ndërkombëtare jashtë fushës së veprimit të kësaj Konvente

Fakti që kjo Konventë nuk zbatohet tek marrëveshjet ndërkombëtare të përfunduara ndërmjet Shteteve dhe subjekteve të tjera të së drejtës ndërkombëtare ose ndërmjet subjekteve të tjerë të së drejtës ndërkombëtare, ose në marrëveshjet ndërkombëtare të formës jo-shkresore, nuk do të ndikojë në :

(a) fuqinë ligjore të marrëveshjeve të tilla;

(b) zbatimin tek to të rregullave të vendosura në këtë Konventë ndaj të cilave ato duhej t'i nënshtroheshin sipas së drejtës ndërkombëtare, në mënyrë të pavarur prej Konventës;

(c) zbatimin e Konventës në marrëdhëniet e Shteteve midis tyre sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat janë gjithashtu palë subjekte të tjera të së drejtës.

Neni 4

Mungesa e fuqisë prapavepruese e kësaj Konvente

Pa cenuar zbatimin e rregullave të vendosur në këtë Konventë në bazë të të cilave traktatet do t'i nënshtroheshin së drejtës ndërkombëtare në mënyrë të pavarur nga Konventa, kjo Konventë zbatohet vetëm në traktatet që janë përfunduar prej Shteteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në lidhje me Shtete të tillë.

Neni 5

Traktate që themelojnë organizata ndërkombëtare dhe traktate të miratuara brenda një organizate ndërkombëtare

Kjo Konventë zbatohet ndaj çdo traktati i cili është instrumenti themelues i një organizate ndërkombëtare dhe ndaj çdo traktati të miratuar brenda një organizate ndërkombëtare pa cenuar asnjë prej rregullave përkatëse të organizatës.

PJESA II

PËRFUNDIMI DHE HYRJA NË FUQI E TRAKTATEVE SEKSIONI 1. PËRFUNDIMI I TRAKTATEVE

Neni 6

Aftësia e Shteteve për të përfunduar traktate

Çdo Shtet zotëron aftësinë për të përfunduar traktate.

Neni 7

Fuqitë e plota

1. Një person konsiderohet si përfaqësues i një Shteti për qëllimin e miratimit ose sigurimit të tekstit të një traktati ose për qëllimin e shprehjes së pëlqimit të Shtetit për të qenë i lidhur nga një traktat në qoftë se:

(a) ai paraqet fuqitë e plota përkatëse; ose

(b) bëhet e qartë nga praktika e Shteteve të interesuar, ose nga rrethana të tjera, se ato e konsiderojnë atë si përfaqësuesin e tyre për këtë qëllim dhe të pajisur me fuqi të plota.

2. Konsiderohen si përfaqësues të Shtetit të tyre, në bazë të funksionit që ata kanë dhe pa qenë nevoja e paraqitjes së fuqive të plota, personat e mëposhtëm:

(a) Kryetarët e Shtetit, Kryetarët e Qeverisë dhe Ministrat e Punëve të Jashtme, me qëllimin e kryerjes së të gjithë akteve që lidhen me përfundimin e një traktati;

(b) drejtuesit e misioneve diplomatike, me qëllimin e miratimit të tekstit të një traktati midis Shtetit akreditues dhe Shtetit tek i cili ato janë akredituar;

(c) përfaqësuesit e akredituar prej Shteteve në një konferencë ose organizatë ndërkombëtare ose në ndonjë prej organeve të tyre, me qëllimin e miratimit të tekstit të një traktati në atë konferencë, organizatë ose organ.

Neni 8

Konfirmimi i mëvonshëm i një akti të kryer pa autorizim

Një akt që lidhet me përfundimin e një traktati, i kryer nga një person i cili nuk mund të konsiderohet në bazë të nenit 7 se është autorizuar për të përfaqësuar Shtetin për këtë qëllim, nuk ka pasoja ligjore në qoftë se nuk konfirmohet më pas nga ai Shtet.

Neni 9
Miratimi i tekstit

1. Miratimi i tekstit të një traktati vendoset me pëlqimin e të gjitha Shteteve pjesëmarrëse në hartimin e tij, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 2.

2. Miratimi i tekstit të një traktati në një konferencë ndërkombëtare vendoset me dy të tretat e votave të Shteteve të pranishme në votim, përveç rasteve kur kjo shumicë do të vendosë zbatimin e një rregulli të ndryshëm.

Neni 10
Autentifikimi i tekstit

Teksti i një traktati vendoset si autentik dhe përfundimtar:

(a) me anë të një procedure të tillë që mund të parashikohet në tekst ose të rënë dakord nga Shtetet pjesëmarrëse në përpilimin e tij; ose

(b) në mungesë të një procedure të tillë, me anë të nënshkrimit, nënshkrimit ad referendum ose parafimit nga përfaqësuesit e këtyre Shteteve të tekstit të traktatit ose Aktit Final të një konference që përfshin tekstin.

Neni 11
Mjetet e shprehjes së pëlqimit për të qenë i lidhur nga një traktat

Pëlqimi i një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat mund të shprehet me anë të nënshkrimit, shkëmbimit të instrumenteve që ligjërojnë një traktat, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit ose nga ndonjë mjet tjetër, në qoftë se bihet dakord për këtë.

Neni 12
Pëlqimi për të qenë i lidhur nga një traktat i shprehur me anë të nënshkrimit

1. Pëlqimi i një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat shprehet nga nënshkrimi prej përfaqësuesit të tij kur:

traktati parashikohet që ky nënshkrim do të ketë atë pasojë;

(b) është vendosur ndryshe nga Shtetet palë në bisedime të cilat kanë rënë dakord që nënshkrimi do të ketë atë pasojë; ose

(c) qëllimi i Shtetit për t'i dhënë atë pasojë nënshkrimit, bëhet i qartë nga fuqitë e plota që i janë dhënë përfaqësuesve të tij ose ky qëllim ishte shprehur gjatë bisedimeve.

2. Për qëllimet e paragrafit 1:

(a) parafimi i një teksti përbën një nënshkrim të një traktati, kur është vendosur që Shtetet palë në bisedime bien dakord për këtë;

(b) nënshkrimi ad referendum i një traktati nga një përfaqësues, në qoftë se kjo gjë konfirmohet nga Shteti i tij, përbën një nënshkrim të plotë të traktatit.

Neni 13
Pëlqimi për të qenë i lidhur nga një traktat i shprehur nga një shkëmbim i instrumenteve që ligjërojnë një traktat

Pëlqimi i Shteteve për të qenë të lidhur nga një traktat i vendosur nga instrumente të shkëmbyera midis tyre është shprehur nga ky shkëmbim kur :

(a) instrumentet parashikojnë që shkëmbimi i tyre do të ketë efekt; ose

(b) është vendosur ndryshe nga këto Shtete të cilët kanë rënë dakord që shkëmbimi i instrumenteve do të ketë atë pasojë.

Neni 14

Pëlqimi për të qenë i lidhur nga një traktat i shprehur me anë të ratifikimit, pranimit ose miratimit

1. Pëlqimi i një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat shprehet me anë të ratifikimit kur:

(a) traktati parashikon që një pëlqim i tillë të shprehet me anë të ratifikimit;

(b) është vendosur ndryshe nga Shtetet palë në bisedime, të cilat kanë rënë dakord që duhet të kërkohet ratifikimi;

(c) përfaqësuesi i Shtetit ka firmosur traktatin që i nënshtrohet ratifikimit; ose

(d) qëllimi i Shtetit për të nënshkruar traktatin që i nënshtrohet ratifikimit bëhet i qartë nga fuqitë e plota të përfaqësuesve të tij ose, ky qëllim është shprehur gjatë bisedimeve.

2. Pëlqimi i një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat është shprehur nga pranimi ose miratimi sipas kushteve të ngjashme me ato që zbatohen për ratifikimin.

Neni 15

Pëlqimi për të qenë i lidhur nga një traktat i shprehur me anë të aderimit

Pëlqimi i një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat është shprehur me anë të aderimit në rastet kur :

(a) traktati parashikon se pëlqimi i Shtetit mund të shprehet me anë të aderimit;

(b) është vendosur ndryshe nga Shtetet palë në bisedime, të cilët kanë rënë dakord që një pëlqim i tillë mund të shprehet nga ky Shtet me anë të aderimit; ose

(c) të gjitha palët kanë rënë më pas dakord që pëlqimi i Shtetit mund të shprehet me anë të aderimit.

Neni 16

Shkëmbimi ose depozitimi i instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit

Në qoftë se traktati nuk parashikon ndryshe, instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit vendosin pëlqimin e një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat në bazë të :

(a) shkëmbimit të tyre ndërmjet Shteteve kontraktuese;

(b) depozitimit të tyre pranë depozituesit; ose

(c) njoftimit të tyre te Shtetet kontraktuese ose të depozituesit, në qoftë se bihet dakord për këtë.

Neni 17

Pëlqimi për të qenë i lidhur nga një pjesë e traktatit dhe zgjedhja e dispozitave të ndryshme

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 19 deri 23, pëlqimi i një Shteti për të qenë i lidhur nga një pjesë e një traktati ka efekt vetëm në qoftë se traktati e lejon këtë ose, Shtetet e tjera kontraktuese bien dakord për këtë.

2. Pëlqimi i një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat i cili lejon zgjedhjen midis dispozitave të ndryshme të tij ka efekt vetëm në qoftë se bëhet e qartë se për cilat dispozita ka të bëjë pëlqimi.

Neni 18

Detyrimi për të mos dëmtuar objektin dhe qëllimin e një traktati përpara hyrjes në fuqi të tij

Një Shtet është i detyruar që të mos kryejë akte të cilat do të dëmtonin objektin dhe qëllimin e një traktati në rastet kur :

(a) ai ka nënshkruar traktatin ose ka shkëmbyer instrumentet që e bëjnë traktatin subjekt të ratifikimit, pranimit ose miratimit, derisa ai të ketë bërë të qartë qëllimin e tij për të mos qenë palë në

traktat;

(b) ai ka shprehur pëlqimin e tij për të qenë i lidhur nga traktati, deri në momentin e hyrjes në fuqi të tij dhe me kusht që kjo hyrje në fuqi të mos jetë vonuar pa shkaqe të arsyeshme.

SEKSIONI 2.
REZERVAT

Neni 19
Formulimi i rezervave

Një Shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në një traktat, mund të formulojë një rezervë, përveç rasteve kur:

(a) rezerva është ndaluar nga traktati;

(b) traktati parashikon që mund të bëhen vetëm rezerva të posaçme, të cilat nuk përfshijnë rezervën në fjalë; ose

(c) në rastet që nuk trajtohen sipas nen-paragrafeve (a) dhe (b), rezerva është e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e traktatit.

Neni 20
Pranimi dhe kundërshtimi i rezervave

1. Një rezervë e autorizuar shprehimisht prej një traktati nuk kërkon ndonjë pranim të mëvonshëm nga Shtetet e tjerë kontraktues përveç rasteve kur traktati nuk parashikon këtë.

2. Një rezervë kërkon pranimin nga të gjitha palët, atëherë kur bëhet e qartë nga numri i kufizuar i Shteteve palë në bisedime, si dhe objekti dhe qëllimi i një traktati, që zbatimi në tërësinë e tij ndërmjet të gjitha palëve kushtëzohet nga pëlqimi i secilit prej tyre për të qenë të lidhur nga traktati.

3. Në rastet kur një traktat është një dokument përbërës i një organizate ndërkombëtare dhe në qoftë se ai nuk parashikon ndryshe, një rezervë kërkon pranimin e organit kompetent të kësaj organizate.

4. Në rastet të cilët nuk trajtohen nga paragrafët e mësipërm dhe në qoftë se traktati nuk parashikon ndryshe :

(a) pranimi nga një Shtet tjetër kontraktues i një rezerve e bën Shtetin rezervues palë të traktatit në lidhje me atë Shtet në qoftë se ose në rastet kur traktati është një forcë për ato shtete;

(b) një kundërshtim nga një Shtet tjetër kontraktues i një rezerve nuk pengon hyrjen në fuqi të traktatit midis shteteve kundërshtuese dhe rezervuese me përjashtim të rasteve kur është shprehur përfundimisht një qëllim i kundërt nga shteti kundërshtues;

(c) një akt që shpreh pëlqimin e një shteti për të qenë i lidhur nga një traktat dhe që përmban një rezervë ka fuqi në momentin kur të paktën një shtet tjetër kontraktues ka pranuar rezervën.

5. Për qëllimet e paragrafeve 2 dhe 4 dhe në qoftë se traktati nuk parashikon ndryshe, një rezervë konsiderohet se ka qenë pranuar nga një shtet në qoftë se ai nuk ka bërë ndonjë kundërshtim ndaj rezervës deri në fund të një periudhe dymbëdhjetë mujore prej datës që ai është njohur me të ose, prej datës në të cilën është shprehur pëlqimi i tij për të qenë i lidhur nga traktati, cilado që të jetë i fundit.

Neni 21
Pasojat ligjore të rezervave dhe të kundërshtimeve të rezervave

1. Një rezervë e bërë në lidhje me një palë tjetër në përputhje me nenet 19, 20, 23:

(a) modifikon për shtetin rezervues në marrëdhëniet e tij me këtë palë tjetër, dispozitat e traktatit me të cilat lidhet rezerva në kufijtë e rezervës; dhe

(b) modifikon në të njëjtën masë ato dispozita për këtë palë tjetër lidhur me marrëdhëniet e saj me shtetin rezervues.

2. Rezerva nuk modifikon inter se dispozitat e traktatit për palët e tjera në të.

3. Në rastet kur një shtet i cili kundërshton një rezervë nuk ka kundërshtuar hyrjen në fuqi të traktatit midis tij dhe shtetit rezervues, dispozitat me të cilat lidhet rezerva nuk do të zbatohen midis

këtyre dy shteteve deri në masën e rezervës.

Neni 22
Tërheqja e rezervave dhe e kundërshtimeve të rezervave

1. Përveç rasteve kur traktati parashikon ndryshe, një rezervë mund të tërhiqet në çdo kohë dhe nuk kërkohet për tërheqjen e saj pëlqimi i një shteti i cili e ka pranuar rezervën.

2. Përveç rasteve kur traktati parashikon ndryshe, kundërshtimi i një rezerve mund të tërhiqet në çdo kohë.

3. Përveç rasteve kur traktati parashikon ndryshe, ose është rënë dakord ndryshe :

(a) tërheqja e një rezerve bëhet efektive për një shtet tjetër kontraktues vetëm atëherë kur është marrë njoftimi për të nga ky Shtet;

(b) tërheqja e një kundërshtimi të një rezerve bëhet efektive vetëm atëherë kur njoftimi është marrë nga shteti i cili ka formuluar rezervën.

Neni 23
Procedura në lidhje me rezervat

1. Një rezervë, një shprehje e pranimit të saj dhe një kundërshtim i një rezerve duhet të formulohet me shkrim dhe t'i komunikohet shteteve kontraktuese dhe shteteve të tjera që kanë të drejtën të jenë palë në traktat.

2. Në qoftë se rezerva formulohet në kohën e nënshkrimit të traktatit, i cili i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, ajo duhet të konfirmohet formalisht nga shteti rezervues në kohën e shprehjes së pëlqimit të tij për të qenë i lidhur nga traktati. Në një rast të tillë rezerva do të konsiderohet se është bërë në datën e konfirmimit të saj.

3. Një shprehje e pranimit ose e kundërshtimit të pranimit të një rezerve e bërë përpara konfirmimit të rezervës nuk kërkon konfirmim.

4. Tërheqja e një rezerve ose e një kundërshtimi të një rezerve duhet të formulohet me shkrim.

SEKSIONI 3
HYRJA NË FUQI DHE ZBATIMI I PËRKOHSHËM
I TRAKTATEVE

Neni 24
Hyrja në fuqi

1. Një traktat hyn në fuqi sipas mënyrës dhe në një datë që mund ta parashikojë ai ose siç mund të bien dakord Shtetet palë në bisedime.

2. Në mungesë të një dispozite apo marrëveshjeje të tillë, një traktat hyn në fuqi sapo të jepet pëlqimi nga të gjithë shtetet palë në bisedime për të qenë të lidhur nga ky traktat.

3. Në rastet kur pëlqimi i një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat është dhënë në një datë pas hyrjes në fuqi të traktatit, ai hyn në fuqi në atë datë për atë shtet, përveç rasteve kur traktati parashikon ndryshe.

4. Dispozitat e një traktati që rregullojnë barazvlefshmërinë e tekstit të tij, dhënien e pëlqimit të Shteteve për të qenë të lidhur nga traktati, mënyra ose data e hyrjes në fuqi të tij, rezervat, funksionet e depozitimit dhe çështjet e tjera që ngrihen në mënyrë të nevojshme përpara hyrjes në fuqi të traktatit, zbatohen që nga koha e miratimit të tekstit.

Neni 25
Zbatimi i përkohshëm

1. Një traktat ose një pjesë e një traktati zbatohet përkohësisht deri në hyrjen në fuqi të tij në qoftë se:

(a) vetë traktati e parashikon këtë; ose

(b) Shtetet palë në bisedime kanë rënë dakord në një mënyrë tjetër.

2. Në qoftë se traktati nuk parashikon ndryshe ose Shtetet palë në bisedime kanë rënë dakord ndryshe, zbatimi i përkohshëm i një traktati ose i një pjese të një traktati në lidhje me një Shtet do të përfundojë në qoftë se ai Shtet do të njoftojë Shtetet e tjera midis të cilëve traktati zbatohet përkohësisht mbi qëllimin e tij për të mos qenë palë në traktat.

PJESA III
RESPEKTIMI, ZBATIMI DHE INTERPRETIMI I TRAKTATEVE
SEKSIONI 1. RESPEKTIMI I TRAKTATEVE

Neni 26
Pacta sunt servanda

Çdo traktat në fuqi është detyrues për palët në të dhe duhet të kryhet prej tyre në mirëbesim.

Neni 27
E drejta e brendshme dhe respektimi i traktateve

Një palë nuk mund të përdorë dispozitat e së drejtës së brendshme si justifikim për pamundësinë e tij për të zbatuar një traktat. Ky rregull nuk do të cenojë nenin 46.

SEKSIONI 2.
ZBATIMI I TRAKTATEVE

Neni 28
Mungesa e fuqisë prapavepruese të traktateve

Në qoftë se nuk del një qëllim i ndryshëm nga traktati ose është vendosur ndryshe, dispozitat e tij nuk janë detyruese për një palë në lidhje me çdo akt ose fakt i cili ka ndodhur ose çdo situatë e cila ka pushuar së ekzistuari përpara datës së hyrjes në fuqi të traktatit për atë palë.

Neni 29
Sfera e veprimit territorial të traktateve

Në qoftë se nuk del një qëllim i ndryshëm nga traktati ose është vendosur ndryshe, një traktat është detyrues për secilën palë në tërë territorin e saj.

Neni 30
Zbatimi i një sërë traktateve që kanë të bëjnë me të njëjtën përmbajtje thelbësore

1. Të drejtat dhe detyrimet e Shteteve palë në traktatet e njëpasnjëshme me të njëjtin objekt, që i nënshtrohen dispozitave të nenit 103 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, do të caktohen në përputhje me paragrafet e mëposhtëm.
2. Në rastet kur një traktat specifikon se i nënshtrohet, ose nuk duhet të konsiderohet si i papajtueshëm me një traktat më të hershëm ose të mëvonshëm, dispozitat e traktatit tjetër do të mbizotërojnë.
3. Në rastet kur të gjitha palët në një traktat të hershëm janë gjithashtu palë në traktatin e mëvonshëm, por traktati më i hershëm nuk ka pushuar ose nuk është pezulluar së vepruari në bazë të nenit 59, traktati më i hershëm zbatohet vetëm në atë masë që dispozitat e tij janë në pajtim me ato të traktatit të mëvonshëm.
4. Në rastet kur në palët e një traktati të mëvonshëm nuk përfshihen në një traktat më të hershëm:
(a) midis Shteteve Palë në të dy traktatet zbatohet i njëjti rregull si në paragrafin 3;

(b) midis një Shteti Palë në të dy traktatet dhe një Shtet Palë në vetëm një prej tyre, traktati në të cilin janë palë të dy Shtetet do të rregullojë të drejtat dhe detyrimet e tyre reciproke.

5. Paragrafi 4 nuk do të cenojë nenin 41, ose ndonjë çështje të pushimit ose të pezullimit të një traktati në bazë të nenit 60 ose ndonjë çështje të përgjegjësisë e cila mund të ngrihet për një Shtet nga përfundimi ose zbatimi i një traktati, dispozitat e të cilit janë të papajtueshme me detyrimet e tij kundrejt një Shteti tjetër në bazë të një traktati tjetër.

SEKSIONI 3.
INTERPRETIMI I TRAKTATEVE

Neni 31
Rregulli i përgjithshëm i interpretimit

1. Një traktat do të interpretohet në mirëbesim në përputhje me kuptimin e zakonshëm që u jepet termave të traktatit në kontekstin e tyre në dritën e objektit dhe qëllimit të tij.

2. Konteksti për qëllimin e interpretimit të një traktati do të përmbajë, përveç tekstit, duke përfshirë hyrjen e tij dhe anekset :

(a) çdo marrëveshje që ka të bëjë me traktatin i cili është bërë ndërmjet të gjitha palëve në lidhje me përfundimin e një traktati;

(b) çdo instrument i cili është bërë nga një ose më shumë palë në lidhje me përfundimin e traktatit dhe i pranuar nga palët e tjera si një instrument që ka të bëjë me traktatin.

3. Do të merren parasysh, bashkë me kontekstin:

(a) çdo marrëveshje e mëvonshme ndërmjet palëve përsa i përket interpretimit të traktatit ose zbatimit të dispozitave të tij;

(b) çdo praktikë e mëvonshme në zbatimin e traktatit, i cili vendos marrëveshjen e palëve në lidhje me interpretimin e tij;

(c) çdo rregull përkatës i së drejtës ndërkombëtare i zbatueshëm në marrëdhëniet midis palëve.

4. Një termi do t'i jepet një kuptim i posaçëm në qoftë se është vendosur se palët kishin pasur këtë qëllim.

Neni 32
Mjetet plotësuese të interpretimit

Mund të kërkohet ndihma e mjeteve plotësuese të interpretimit, duke përfshirë punën përgatitore të traktatit dhe rrethanat e përfundimit të tij, me qëllimin për të konfirmuar kuptimin që rezulton nga zbatimi i nenit 31, ose për të përcaktuar kuptimin kur interpretimi sipas nenit 31 :

(a) e le kuptimin të paqartë ose të pakuptueshëm; ose

(b) çon në një rezultat i cili është në mënyrë të qartë absurd ose i paarsyeshëm.

Neni 33
Interpretimi i traktateve të autentikuar në një ose më shumë gjuhë

1. Në rastet kur një traktat është autentikuar në një ose më tepër gjuhë, teksti ka të njëjtin autoritet në secilën gjuhë, në qoftë se traktati nuk parashikon ndryshe ose palët bien dakord që, në rast mosmarrëveshjeje, një tekst i veçantë do të mbizotërojë.

2. Një version i traktatit në një gjuhë përveç atyre në të cilat është autentikuar teksti do të konsiderohet një tekst autentik vetëm në qoftë se kështu e parashikon traktati ose palët bien dakord për këtë.

3. Termat e traktatit presupozohet se kanë të njëjtin kuptim në secilin tekst autentik.

4. Përveç rasteve kur mbizotëron një tekst i veçantë në përputhje me paragrafin 1, atëherë kur një krahasim me tekstin autentik zbulon një ndryshim kuptimi të cilin zbatimi i neneve 31 dhe 32 nuk e heq (largon), do të adaptohet kuptimi i cili i pajton më mirë tekstet, duke pasur parasysh objektin dhe qëllimin e traktatit.

SEKSIONI 4.
TRAKTATET DHE SHTETET E TRETA

Neni 34
Rregulli i përgjithshëm në lidhje me Shtetet e treta

Një traktat nuk krijon as detyrime dhe as të drejta për një Shtet të tretë pa pëlqimin e tij.

Neni 35
Traktate që parashikojnë detyrime për Shtetet e treta

Një detyrim rrjedh për një Shtet të tretë nga një dispozitë e një traktati në qoftë se palët në të synojnë që dispozita që do të jetë mjeti i vendosjes së detyrimit dhe Shteti i tretë e pranon atë detyrim duke e shprehur me shkrim.

Neni 36
Traktate që parashikojnë të drejta për Shtetet e treta

1. Një e drejtë rrjedh për një Shtet të tretë nga një dispozitë e një traktati në qoftë se palët në të synojnë që ajo t'i akordojë atë të drejtë ose një Shteti të tretë, ose një grupi shtetesh të cilëve ajo u përket, ose të gjithë shteteve, ku për pasojë dhe shteti i tretë jep pëlqimin e tij. Pëlqimi i tij do të prezumohet për aq kohë sa nuk shprehet e kundërta,në qoftë se traktati nuk parashikon ndryshe.
2. Një shtet gjatë ushtrimit të një të drejte në përputhje me paragrafin 1 do të veprojë në përputhje me kushtet për këtë ushtrim të parashikuar në traktat ose të vendosur në pajtim me traktatin.

Neni 37
Revokimi ose modifikimi i detyrimeve ose të drejtave të Shteteve të tretë

1. Në rastet kur ka rrjedhur një detyrim për një shtet të tretë në përputhje me nenin 35, detyrimi mund të revokohet ose modifikohet vetëm me pëlqimin e palëve në traktat dhe të shteteve të tretë, në qoftë se nuk është vendosur që ata kanë rënë dakord ndryshe.
2. Në rastet kur ka rrjedhur një e drejtë në përputhje me nenin 36, e drejta nuk mund të revokohet ose modifikohet nga palët në qoftë se është vendosur që e drejta nuk kishte pasur qëllim të revokohej ose t'i nënshtrohej modifikimit pa pëlqimin e Shtetit të tretë.

Neni 38
Rregullat e një traktati që bëhen detyruese për Shtetet e treta përmes zakonit ndërkombëtar

Asgjë në nenet 34 dhe 37 nuk ndalon një rregull të parashikuar në një traktat për të qenë i detyrueshëm për një shtet të tretë si një rregull zakonor i së drejtës ndërkombëtare, i njohur si i tillë.

PJESA IV
AMENDAMENTET DHE MODIFIKIMI I TRAKTATEVE

Neni 39
Rregulla të përgjithshme në lidhje me amendimin e traktateve

Një traktat mund të amendohet me anë të marrëveshjes ndërmjet palëve. Rregullat janë të vendosura në Pjesën II në një marrëveshje të tillë përveç rasteve kur traktati mund të parashikojë ndryshe.

Neni 40
Amendimi i traktateve shumëpalëshe

1. Në qoftë se traktati nuk parashikon ndryshe, amendimi i traktateve shumëpalëshe do të rregullohet nga paragrafet e mëposhtëm.

2. Çdo propozim për të amenduar një traktat shumëpalësh midis të gjitha palëve duhet t'i njoftohet të gjithë shteteve kontraktues, ku secili prej tyre do të ketë të drejtën që të marrë pjesë në :

(a) vendimin përsa i përket veprimit që do të merret në lidhje me një propozim të tillë;

(b) bisedimet në lidhje me çdo marrëveshje dhe përfundimin e saj për amendimin e traktatit.

3. Çdo shtet që ka të drejtën për të qenë palë e traktatit do të ketë gjithashtu të drejtën të jetë palë në traktatin e amenduar.

4. Marrëveshja amenduese nuk e detyron një Shtet që është palë në traktat i cili nuk bëhet palë në marrëveshjen amenduese; neni 30, paragrafi 4(b) zbatohet në lidhje me një shtet të tillë.

5. Çdo shtet i cili bëhet palë në një traktat pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes amenduese, në mungesë të shprehjes së një qëllimi të ndryshëm nga ai Shtet;

(a) do të konsiderohet si palë e traktatit të amenduar; dhe

(b) do të konsiderohet si palë e traktatit të amenduar në lidhje me çdo palë të traktatit të padetyruar nga marrëveshja amenduese.

Neni 41
Marrëveshjet për të modifikuar traktatet shumëpalëshe vetëm ndërmjet palëve të përcaktuara

1. Dy ose më shumë palë në një traktat shumëpalësh mund të përfundojnë një marrëveshje për të modifikuar traktatin vetëm midis tyre në qoftë se:

(a) mundësia e një modifikimi të tillë është parashikuar nga traktati; ose

(b) modifikimi në fjalë nuk është ndaluar nga traktati dhe:

(i) nuk prek gëzimin e të drejtave ose përmbushjen e detyrimeve që palët kanë në bazë të traktatit;

(ii) nuk lidhet me ndonjë dispozitë, cenimi i së cilës është i papajtueshëm me përmbushjen efektive të objektit dhe qëllimit të traktatit në tërësi.

2. Në qoftë se për një çështje që trajtohet nga paragrafi 1 (a) traktati nuk parashikon ndryshe, palët në fjalë do të njoftojnë palët e tjera në lidhje me qëllimin e tyre për të përfunduar marrëveshjen dhe për modifikimin e trakatit që ajo parashikon.

PJESA V
PAVLEFSHMËRIA, PËRFUNDIMI DHE PEZULLIMI I VEPRIMIT TË TRAKTATEVE

SEKSIONI 1.
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 42
Vlefshmëria dhe kohëvazhdimi në fuqi i traktateve

1. Vlefshmëria e një traktati ose e pëlqimit të një shteti për të qenë i lidhur nga një traktat mund të kundërshtohet vetëm përmes zbatimit të kësaj Konvente.

2. Pushimi i veprimit të një traktati, denoncimi i tij ose tërheqja e një pale, mund të vendoset vetëm si rezultat i zbatimit të dispozitave të traktatit ose të kësaj Konvente. I njëjti rregull zbatohet ndaj pezullimit të veprimit të një traktati.

Neni 43
Detyrimet që ngarkohen nga e drejta ndërkombëtare
në mënyrë të pavarur nga një traktat

Pavlefshmëria, pushimi, denoncimi ose pezullimi i veprimit të një traktati, ose tërheqja e një pale prej tij, si rezultat i zbatimit të kësaj Konvente ose i dispozitave të traktatit, nuk do të cenojë në asnjë mënyrë detyrimin e ndonjë shteti për të përmbushur detyrimet e përfshira në traktat, të cilave ai i nënshtrohet në bazë të së drejtës ndërkombëtare në mënyrë të pavarur nga traktati.

Neni 44
Ndarja e dispozitave të traktatit

1. Një e drejtë e një pale, e parashikuar në një traktat ose që rrjedh në bazë të nenit 56, për të denoncuar, për t'u tërhequr ose pezulluar veprimin e traktatit mund të ushtrohet vetëm në lidhje me të gjithë traktatin në qoftë se traktati nuk parashikon, ose palët bien dakord, ndryshe.

2. Një arsye për ta bërë të pavlefshëm, pushuar ose pezulluar së vepruari, ose për t'u tërhequr nga një traktat i njohur në këtë Konventë mund të kërkohet vetëm në lidhje me të gjithë traktatin përveç rasteve të parashikuara në paragrafet e mëposhtëm ose në nenin 60.

3. Në qoftë se arsyeja lidhet vetëm me dispozita të veçanta, ajo mund të kërkohet vetëm në lidhje me ato dispozita aty ku:

(a) dispozitat në fjalë janë të ndara nga pjesa tjetër e traktatit në lidhje me zbatimin e tyre;

(b) bëhet e qartë nga traktati ose është vendosur ndryshe që pranimi i këtyre dispozitave nuk ka qenë një bazë themelore e pëlqimit të palës tjetër ose e palëve për të qenë të lidhur nga i gjithë traktati; dhe

zbatimi i mëtejshëm i pjesës tjetër të traktatit nuk do të ishte i padrejtë.

4.Në çështjet që hyjnë në kuadrin e neneve 49 dhe 50 Shteti që ka të drejtën të pretendojë mashtrimin ose korrupsionin mund ta bëjë këtë gjë si në lidhje me traktatin në përgjithësi ose me dispozita të veçanta që i nënshtrohen paragrafit 3.

5. Në rastet që hyjnë në kuadrin e neneve 51, 52 dhe 53, nuk lejohet ndarja e dispozitave të traktatit.

Neni 45
Humbja e një të drejte për të kërkuar një arsye për të bërë të pavlefshëm,
pushuar ose pezulluar së vepruari një traktat apo për t'u tërhequr prej tij

Një Shtet nuk mund të kërkojë me arsye për të bërë të pavlefshëm, pushuar ose pezulluar së vepruari një traktat apo për t'u tërhequr prej tij në bazë të neneve 46 deri në 50 ose neneve 60 dhe 62, në qoftë se, pas qënies në dijeni të fakteve:

(a) ai do të ketë rënë shprehimisht dakord që traktati është i vlefshëm, mbetet në fuqi ose vazhdon të veprojë, sipas rastit; ose

(b) për shkak të drejtimit të tij ai duhet të konsiderohet sikur të ketë pranuar në heshtje vlefshmërinë e traktatit, mbetjen e tij në fuqi ose në veprim, sipas rastit.

SEKSIONI 2.
PAVLEFSHMËRIA E TRAKTATEVE

Neni 46
Dispozitat e së drejtës së brendshme në lidhje me
kompetencën për të përfunduar traktate

1. Një Shtet nuk mund të kërkojë faktin që pëlqimi i tij për të qenë i lidhur nga një traktat është shprehur duke cenuar një dispozitë të së drejtës së tij të brendshme në lidhje me kompetencën për të përfunduar traktate duke bërë të pavlefshëm pëlqimin e tij, në qoftë se ky cenim nuk ishte i qartë dhe të kishte të bënte me një rregull të së drejtës së tij të brendshme të një rëndësie thelbësore.

2. Një dhunim është i qartë në qoftë se ai do të ishte objektivisht i dukshëm për çdo Shtet që

drejtohet në një mënyrë të tillë që është në përputhje me praktikën normale dhe mirëbesimin.

Neni 47
Kufizime të veçanta në lidhje me autoritetin për të shprehur pëlqimin e një Shteti

Në qoftë se autoriteti i një përfaqësuesi për të shprehur pëlqimin e një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat i veçantë i është nënshtruar një kufizimi të veçantë, mungesa e respektimit nga ana e tij të këtij kufizimi nuk mund të konsiderohet se e bën të pavlefshëm pëlqimin e shprehur prej tij në qoftë se kufizimi nuk u ishte njoftuar shteteve të tjera palë në bisedime përpara shprehjes prej tij të një pëlqimi të tillë.

Neni 48
Gabimi

1. Një Shtet mund të konsiderojë një gabim në një traktat se e bën të pavlefshëm pëlqimin e tij për të qenë i lidhur nga traktati në qoftë se gabimi lidhet me një fakt ose situatë e cila është supozuar nga ai Shtet se ka ekzistuar në kohën kur traktati ishte përfunduar dhe përbënte një bazë themelore për pëlqimin e tij për të qenë i lidhur nga traktati.
2. Paragrafi 1 nuk do të zbatohet në qoftë se Shteti në fjalë ka kontribuar me veprimtarinë e tij në këtë gabim ose në qoftë se rrethanat ishin të tilla për ta vënë atë Shtet në dijeni për një gabim të mundshëm.
3. Një gabim që lidhet vetëm me formulimin e tekstit të një traktati nuk cenon vlefshmërinë e tij, në këtë rast zbatohet neni 79.

Neni 49
Mashtrimi

Në qoftë se një Shtet është shtyrë që të përfundojë një traktat nëpërmjet veprimit mashtrues të një Shteti tjetër palë në bisedime, Shteti mund të konsiderojë mashtrimin se e bën të pavlefshëm pëlqimin e tij për të qenë i lidhur nga traktati.

Neni 50
Korruptimi i një përfaqësuesi të një Shteti

Në qoftë se shprehja e pëlqimit të një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat është shkaktuar nëpërmjet korruptimit të një përfaqësuesi të tij direkt ose indirekt nga një shtet tjetër palë në bisedime, shteti mund të konsiderojë një korruptim të tillë se e bën të pavlefshëm pëlqimin e tij për të qenë i lidhur nga traktati.

Neni 51
Shtrëngimi i përfaqësuesit të një Shteti

Shprehja e pëlqimit të një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat, i cili është shkaktuar nga shtrëngimi i përfaqësuesit të tij nëpërmjet akteve ose kërcenimeve të drejtuara kundër tij nuk do të ketë fuqi ligjore.

Neni 52
Shtrëngimi i një Shteti nëpërmjet kërcenimit ose përdorimit të forcës

Një traktat është i pavlefshëm në qoftë se përfundimi i tij është shkaktuar nëpërmjet kërcenimit ose përdorimit të forcës, duke dhunuar parimet e së drejtës ndërkombëtare të mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Neni 53

Traktate që konfliktojnë me një normë urdhëruese të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare (jus cogens)

Një traktat është i pavlefshëm, në kohën e përfundimit të tij, në qoftë se ai konflikton me një normë urdhëruese të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare. Për qëllimet e kësaj Konvente, një normë urdhëruese e së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare është një normë e pranuar dhe e njohur nga komuniteti ndërkombëtar i Shteteve në tërësi si një normë e cila nuk duhet të cenohet dhe që mund të modifikohet vetëm me një normë të mëvonshme të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare që ka të njëjtin karakter.

SEKSIONI 3.
PUSHIMI DHE PEZULLIMI I VEPRIMIT
TË TRAKTATEVE

Neni 54

Pushimi së vepruari ose tërheqja prej tij në bazë të dispozitave të tij ose me anë të pëlqimit të palëve

Pushimi i veprimit të një traktati ose tërheqja e një pale prej tij mund të bëhet :

(a) në përputhje me dispozitat e traktatit; ose

(b) në çdo kohë nëpërmjet pëlqimit të të gjitha palëve pas konsultimit me Shtetet e tjera kontraktuese.

Neni 55

Zvogëlimi i palëve në një traktat shumëpalësh nën numrin e nevojshëm për hyrjen e tij në fuqi

Përveç rasteve kur traktati parashikon ndryshe, një traktat shumëpalësh nuk mbaron së vepruari vetëm për shkak të faktit se numri i palëve bie në numrin e nevojshëm për hyrjen e tij në fuqi.

Neni 56

Denoncimi ose tërheqja prej një traktati që nuk përmban ndonjë dispozitë në lidhje me pushimin e veprimit, denoncimin ose tërheqjen

1. Një traktat i cili nuk përmban ndonjë dispozitë në lidhje me pushimin e veprimit të tij dhe i cili nuk parashikon denoncimin ose tërheqjen nuk i nënshtrohet denoncimit ose tërheqjes në qoftë se :

(a) ai nuk përcakton që palët kanë pasur si qëllim që të pranojnë mundësinë e denoncimit ose të tërheqjes; ose

(b) një e drejtë e denoncimit ose e tërheqjes nuk mund të nënkuptojë natyrën e traktatit.

2. Një palë nuk do të japë në më pak se dymbëdhjetë muaj njoftimin në lidhje me qëllimin e tij për të denoncuar traktatin ose për t'u tërhequr prej tij sipas paragrafit 1.

Neni 57

Pezullimi i veprimit të traktatit në bazë të dispozitave të tij ose nëpërmjet pëlqimit të palëve

Veprimi i një traktati në lidhje me të gjitha palët me një palë të veçantë mund të pezullohet:

(a) në përputhje me dispozitat e traktatit; ose

(b) në çdo kohë me pëlqimin e të gjitha palëve pas konsultimit me Shtete të tjera kontraktuese.

Neni 58

Pezullimi i veprimit të një traktati shumëpalësh me anë të marrëveshjes së vetëm disa palëve të veçanta

1. Dy ose më shumë palë në një traktat shumëpalësh mund të përfundojnë një marrëveshje për të pezulluar veprimin e dispozitave të traktatit, përkohësisht dhe vetëm midis tyre, në qoftë se :

(a) mundësia e një pezullimi të tillë është parashikuar nga traktati; ose

(b) Pezullimi në fjalë nuk është ndaluar nga traktati dhe:

(i) nuk cenon përfitimin prej palëve të tjera të të drejtave të tyre në bazë të traktatit ose të përmbushjes së detyrimeve të tyre;

(ii) nuk është i papajtueshëm me objektin dhe qëllimin e traktatit.

2. Në qoftë se traktati nuk parashikon ndryshe për një çështje që trajtohet në kuadrin e paragrafit 1 (a), palët në fjalë do të njoftojnë palët e tjera në lidhje me qëllimin e tyre për të përfunduar marrëveshjen dhe për ato dispozita të traktatit të cilat ato kanë si qëllim që t'i pezullojnë.

Neni 59

Pushimi ose pezullimi i veprimit të një traktati i nënkuptuar me përfundimin e një traktati të mëvonshëm

1. Një traktat do të konsiderohet se ka pushuar së vepruari në qoftë se të gjitha palët në të përfundojnë një traktat të mëvonshëm në lidhje me të njëjtën çështje dhe:

(a) bëhet e qartë nga traktati i fundit ose është vendosur ndryshe që palët kanë pasur qëllim që çështja duhej të rregullohej nga traktati; ose

(b) dispozitat e traktatit të fundit janë të papajtueshme me ato të traktatit më të hershëm sa që është e pamundur që të dy traktat të zbatohen në të njëjtën kohë.

2.Traktati më i hershëm do të konsiderohet vetëm si i pezulluar për të vepruar në qoftë se bëhet e qartë nga traktati i mëvonshëm ose është vendosur ndryshe që ky ka qenë qëllimi i palëve.

Neni 60

Pushimi ose pezullimi i veprimit të një traktati si rezultat i shkeljes së tij

1. Një shkelje materiale e një traktati shumëpalësh nga një prej palëve i jep të drejtën palës tjetër për të konsideruar shkeljen si një arsye për të pushuar ose pezulluar veprimin e plotë ose të pjesshëm të tij.

2. Një shkelje materiale e një traktati shumëpalësh nga një prej palëve i jep të drejtën:

(a) palëve të tjera me një marrëveshje unanime për të pezulluar apo pushuar plotësisht ose pjesërisht veprimin e tij:

(i) në marrëdhëniet midis tyre dhe shtetit që e ka shkelur atë, ose

(ii) ndërmjet të gjitha palëve;

(b) një palë e prekur posaçërisht nga shkelja që ta konsiderojë atë si një arsye për pezullimin e veprimit të një traktati plotësisht ose pjesërisht në marrëdhëniet midis tyre dhe Shtetit shkelës;

(c) çdo palë përveç shtetit shkelës për të konsideruar shkeljen si një arsye për pezullimin e veprimit të traktatit plotësisht ose pjesërisht në lidhje me të në qoftë se traktati është i një karakteri të tillë që një shkelje materiale e dispozitave të tij prej njërës palë ndryshon rrënjësisht qëndrimin e çdo pale në lidhje me përmbushjen e mëtejshme të detyrimeve të tij sipas traktatit.

3.Një shkelje materiale e një traktati, për qëllimet e këtij neni, konsiston në:

(a) një refuzim i traktatit i pasanksionuar nga kjo Konventë; ose

(b) dhunimi i një dispozite thelbësore për përmbushjen e objektit dhe qëllimit të traktatit.

4. Paragrafet e mësipërm nuk cenojnë ndonjë dispozitë të traktatit të zbatueshme në rastin e një shkeljeje.

5. Paragrafet 1 deri në 3 nuk do të zbatohen ndaj dispozitave që lidhen me mbrojtjen e njerëzve të përfshira në traktatet me një karakter humanitar, në veçanti ndaj dispozitave që ndalojnë çdo formë raprezaljeje ndaj personave të mbrojtur nga traktate të tilla.

Neni 61

Pamundësia e përmbushjes së traktatit

1. Një palë mund të konsiderojë pamundësinë e përmbushjes së një traktati si një arsye për pushimin ose tërheqjen prej tij në qoftë se kjo pamundësi rezulton nga shuarja ose prishja e përhershme e një objekti të domosdoshëm për zbatimin e traktatit. Në qoftë se pamundësia është e

përkohshme, ajo mund të konsiderohet si një arsye për pezullimine veprimit të traktatit.

2. Pamundësia e përmbushjes së traktatit nuk mund të konsiderohet si një arsye për pushimin, pezullimin e veprimit të traktatit ose tërheqjen prej tij në qoftë se ajo është rezultat i një shkeljeje nga ajo palë ose të një detyrimi në bazë të traktatit ose të ndonjë detyrimi tjetër ndëkombëtar ndaj ndonjë pale tjetër të traktatit.

Neni 62

Ndryshimi thelbësor i rrethanave

1. Një ndryshim thelbësor i rrethanave, të cilat kanë ndodhur në lidhje me ato që ekzistojnë në kohën e përfundimit të një traktati, dhe që nuk ishte parashikuar nga palët nuk mund të konsiderohet si një arsye për pushimin e traktatit ose tërheqjen prej tij me përjashtim të rasteve kur:

ekzistenca e këtyre rrethanave përbënte një bazë themelore për pëlqimin e palëve për të qenë të lidhura nga traktati; dhe

b) efekti i ndryshimit transformon radikalisht shtrirjen e detyrimeve në bazë të traktatit që kanë mbetur akoma pa u përmbushur.

2. Një ndryshim thelbësor i rrethanave nuk mund të konsiderohet si një arsye për pushimin e veprimit të traktatit ose tërheqjen prej tij:

a) në qoftë se traktati vendos një kufizim; ose

b) në qoftë se ndryshimi thelbësor është rezultat i një shkeljeje nga pala që e paraqet atë ose në lidhje me një detyrim në bazë të traktatit ose në lidhje me çdo detyrim tjetër ndërkombëtar ndaj ndonjë pale tjetër të traktatit.

3. Në qoftë se në bazë të paragrafeve të mësipërme, një palë mund të pretendojë një ndryshim thelbësor të rrethanave si një arsye për pushimin e veprimit të një traktati ose tërheqjen e tij ajo mund ta paraqesë ndryshimin si një arsye për pezullimin e veprimit të traktatit.

Neni 63

Ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike ose konsullore

Ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike ose konsullore ndërmjet palëve të një traktati nuk cenon marrëdhëniet ligjore të vendosura ndërmjet tyre nga traktati përveç për aq sa ekzistenca e marrëdhënieve diplomatike ose konsullore është e domosdoshme për zbatimin e traktatit.

Neni 64

Dalja e një norme urdhëruese të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare (jus cogens)

Në qoftë se del një normë e re e së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare, çdo traktat ekzistues, i cili konflikton me këtë normë, bëhet i pavlefshëm dhe pushon së vepruari.

SEKSIONI 4

PROCEDURA

Neni 65

Procedura që do të ndiqet në lidhje me pavlefshmërinë, pushimin ose pezullimin e veprimit të traktatit apo tërheqjen prej tij

1. Një palë e cila, në bazë të dispozitave të kësaj Konvente, konsideron një të metë në pëlqimin e saj për të qenë e lidhur nga një traktat ose një arsye për të vënë në dyshim vlefshmërinë, pushimin ose pezullimin e veprimit të një traktati ose tërheqjen prej tij, duhet të njoftojë palët e tjera në lidhje me pretendimin e saj. Njoftimi do të tregojë masat që propozohet të merren në lidhje me traktatin dhe për rrjedhojë arsyet për këto masa.

2. Në qoftë se pas mbarimit të një periudhe, e cila nuk do të jetë më pak se tre muaj pas marrjes së njoftimit, përveç rasteve të një urgjence të veçantë, asnjë palë nuk ka ngritur ndonjë kundërshtim, pala që bën njoftimin mund të kryejë në mënyrën e parashikuar në nenin 67 masën që ka propozuar.

3. Megjithatë, në qoftë se janë ngritur kundërshtime nga një palë tjetër, palët do të kërkojnë arritjen e një zgjidhje me anë të mjeteve të parashikuara në nenin 33 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

4. Asgjë në paragrafet e mësipërme nuk do të cenojë të drejtat ose detyrimet e palëve në bazë të dispozitave në fuqi, që janë detyruese për palët në lidhje me zgjidhjen e konflikteve.

5. Pa cenuar nenin 45, fakti që një Shtet nuk ka bërë paraprakisht njoftimin e parashikuar në paragrafin 1 nuk do ta pengojë atë për të bërë një njoftim të tillë në përgjigje të një pale tjetër që kërkon zbatimin e traktatit ose pohon dhunimin e tij.

Neni 66

Procedura e zgjidhjes gjyqësore, arbitrazhi dhe pajtimi

Në bazë të paragrafit 3 të nenit 65, në qoftë se nuk është arritur asnjë zgjidhje brenda një periudhe 12-mujore nga data e bërjes së kundërshtimit, atëherë do të ndiqet procedura e mëposhtëme:

a) çdo njëra prej palëve në konflikt, që ka të bëjë me zbatimin ose interpretimin e neneve 53 ose 64, me anë të një kërkese të shkruar, mund t'ia dorëzojë atë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, për një vendim me përjashtim të rasteve kur palët në marrëveshje midis tyre bien dakord që t'ia paraqesin konfliktin arbitrazhit;

b) çdonjëra prej palëve në konflikt, që ka të bëjë me zbatimin ose interpretimin e një prej neneve në Pjesën V të kësaj Konvente mund të vërë në lëvizje procedurën e specifikuar në Aneksin e Konventës nëpërmjet dorëzimit të një kërkese për këtë qëllim Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 67

Instrumentet për deklarimin e pavlefshmërisë, pushimit ose pezullimit të veprimit të një traktati apo të tërheqjes prej tij

1. Njoftimi i parashikuar në bazë të nenit 65, paragrafi 1, duhet bërë me shkrim.

2. Çdo akt që deklaron pavlefshmërinë, pushimin ose pezullimin e veprimit të traktatit apo tërheqjen prej tij në përputhje me dispozitat e traktatit ose të paragrafeve 2 ose 3 të nenit 65 do të kryhet nëpërmjet një instrumenti që u komunikohet palëve të tjera. Në qoftë se instrumenti nuk është i nënshkruar nga Kryetari i Shtetit, Kryetari i Qeverisë ose Ministri i Punëve të Jashtme, përfaqësuesit të Shtetit, që e komunikon atë mund t'i kërkohet që të paraqesë fuqitë e plota.

Neni 68

Revokimi i njoftimeve dhe instrumenteve të parashikuara në nenet 65 dhe 67

Një njoftim ose instrument i parashikuar në nenet 65 dhe 67 mund të revokohet në çdo kohë përpara hyrjes në fuqi të tij.

SEKSIONI 5
PASOJAT E PAVLEFSHMËRISË, PUSHIMIT
OSE TË PEZULLIMIT TË TRAKTATIT

Neni 69

Pasojat e pavlefshmërisë së traktatit

1. Një traktat pavlefshmëria e të cilit është vendosur në bazë të kësaj Konvente është i pavlefshëm. Dispozitat e një traktati të pavlefshëm nuk kanë fuqi ligjore.

2. Megjithatë, në qoftë se aktet janë kryer në mbështetje të një traktati të tillë:

a) çdo palë mund t'i kërkojë çdo pale tjetër të vendosë (përcaktojë), për aq sa është e mundur në marrëdhëniet e tyre reciproke qëndrimin, që duhej të kishte ekzistuar në qoftë se aktet nuk kanë qenë kryer;

b) aktet e kryera në mirëbesim përpara pretendimit të pavlefshmërisë nuk janë bërë të paligjshme vetëm për shkak të pavlefshmërisë së traktatit.

3. Në çështjet që hyjnë në kuadrin e neneve 49, 50, 51 ose 52, paragrafi 2 nuk zbatohet në lidhje me palën ndaj së cilës ngarkohet mashtrimi, akti i korruptimit ose i shtrëngimit.

4. Në raste të pavlefshmërisë së pëlqimit të një Shteti për të qenë i lidhur nga një traktat shumëpalësh, rregullat e mësipërme zbatohen ndërmjet atij Shteti dhe palëve në traktat.

Neni 70

Pasojat e pushimit të veprimit të një traktati

1. Përveç rasteve kur traktati parashikon ndryshe ose palët bien dakord ndryshe, pushimi i një traktati bëhet në bazë të dispozitave të tij ose në përputhje me këtë Konventë:

i liron palët nga detyrimi për të zbatuar më tej traktatin;

b) nuk cenon ndonjë të drejtë, detyrim ose gjendje ligjore të palëve të krijuar përmes ekzekutimit të traktatit përpara pushimit të veprimit të tij.

2. Në qoftë se një Shtet denoncon ose tërhiqet nga një traktat shumëpalësh, paragrafi 1 zbatohet në marrëdhëniet ndërmjet atij Shteti dhe seicilës prej palëve të tjera të traktatit nga data kur një denoncim ose tërheqje e tillë hyn në fuqi.

Neni 71

Pasojat e pavlerfshmërisë së një traktati, i cili konflikton me një normë urdhëruese të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme

1. Në rastin kur një traktat, i cili është i pavlefshëm në bazë të nenit 53, palët:

a) do të eleminojnë sa të jetë e mundur pasojat e një akti të kryer në mbështetje të ndonjë dispozite, e cila konflikton me një normë urdhëruese të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme; dhe

b) do t'i drejtojë marrëdhëniet e tyre reciproke në përputhje me normën detyruese të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme.

2. Në rastin e një traktati, i cili bëhet i pavlefshëm dhe pushon së vepruari në bazë të nenit 64, ky pushim i traktatit:

i liron palët nga çdo detyrim i mëtejshëm për të zbatuar traktatin;

b) nuk cenon ndonjë të drejtë, detyrim ose gjendje ligjore të palëve të krijuar nëpërmjet ekzekutimit të traktatit përpara pushimit të veprimit të tij; me kusht që këto të drejta, detyrime ose gjendje këtej e tutje mund të mbahen vetëm në masën që mbajtja e tyre në vetvete nuk konflikton me normën e re urdhëruese të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme.

Neni 72

Pasojat e pezullimit të veprimit të një traktati

1. Në qoftë se traktati nuk parashikon ndryshe ose palët bien dakord ndryshe, pezullimi i veprimit të një traktati në bazë të dispozitave të tij apo në përputhje me këtë Konventë:

a) i liron palët ndërmjet të cilave veprimi i traktatit është pezulluar nga detyrimi për të zbatuar traktatin në marrëdhëniet e tyre reciproke gjatë periudhës së pezullimit;

b) nuk cenon ndryshe marrëdhëniet ligjore ndërmjet palëve të vendosura nga traktati.

2. Gjatë periudhës së pezullimit palët nuk do të kryejnë asnjë akt, që përpiqet të pengojë vazhdimin e veprimit të traktatit.

PJESA VI

DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 73

Rastet e suksedimit dhe përgjegjësisë së Shteteve dhe fillimi i veprimeve luftarake

Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të cenojnë ndonjë çështje që mund të ngrihet në lidhje me një traktat nga një suksedim i Shteteve ose nga përgjegjësia ndërkombëtare e një Shteti ose nga fillimi i veprimeve luftarake ndërmjet Shteteve.

Neni 74
Marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore dhe përfundimi i traktateve

Ndërprerja ose mungesa e marrëdhënieve diplomatike ose konsullore ndërmjet dy ose më shumë Shteteve nuk pengon përfundimin e traktateve ndërmjet këtyre Shteteve. Përfundimi i një traktati në vetvete nuk prek qëndrimin në lidhje me marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore.

Neni 75
Rasti i një Shteti agresor

Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë ndonjë detyrim në lidhje me ndonjë traktat, i cili mund të ngrihet për ndonjë Shtet agresor si rezultat i masave të marra në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara në lidhje me këtë agresion.

PJESA VII
DEPOZITIMET, NJOFTIMET, NDREQJET DHE REGJISTRIMI

Neni 76
Depozitimet e traktateve

1. Caktimi i depozituesit të një traktati mund të bëhet nga Shtetet palë në bisedime, ose në vetë traktatin apo në ndonjë mënyrë tjetër. Depozituesi mund të jetë një ose më shumë Shtete, një organizatë ndërkombëtare ose drejtuesi administrativ i organizatës.

2. Funksionet e depozituesit kanë karakter ndërkombëtar dhe ai është i detyruar të veprojë në mënyrë të paanëshme në zbatimin e tyre. Në veçanti, fakti që një traktat nuk ka hyrë në fuqi ndërmjet palëve të caktuara ose që është shfaqur një dallim ndërmjet një Shteti dhe një depozituesi në lidhje me kryerjen e funksioneve të këtij të fundit nuk do të prekë këtë detyrim.

Neni 77
Funksionet e depozituesve

1. Funksionet e një depozituesi, në qoftë se nuk është parashikuar ndryshe në traktat ose të jetë rënë dakord nga Shtetet kontraktuese, përfshijnë në veçanti:

a) mbajtjen në ruajtje të tekstit origjinal të traktatit dhe të gjitha të drejtat e dhëna ndaj depozituesve;

b) përgatitjen e kopjeve të vërtetuara të tekstit origjinal dhe përgatitjen e çdo teksti të mëtejshëm të traktatit në gjuhë të tilla plotësuese siç mund të kërkohet nga traktati dhe transmetimi i tyre palëve dhe Shteteve, që kanë të drejtë që të jenë palë në traktat;

c) pranimin e nënshkrimeve të trakatit dhe pranimi dhe mbajtja në ruajtje e çdo instrumenti, njoftimi dhe komunikimi në lidhje me të;

d) shqyrtimi nëse nënshkrimi ose çdo instrument, njoftim ose komunikim në lidhje me traktatin është në formën e duhur dhe të përshtatshme dhe, në qoftë se është nevoja, ta çojë çështjen në vëmendjen e Shtetit në fjalë;

e) informimin e palëve dhe të Shteteve, që bëjnë pjesë në një traktat në lidhje me aktet, njoftimet dhe komunikimet në lidhje me traktatin;

f) informimi i Shteteve, që kanë të drejtë të bëhen palë në traktat kur numri i nënshkrimeve ose i instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit i kërkuar për hyrjen në fuqi të traktatit është marrë ose depozituar;

g) regjistrimi i traktatit te Sekretariati i Kombeve të Bashkuara;

h) kryerja e funksioneve të specifikuara në dispozita të tjera të kësaj Konvente.

2. Në rastin e një dallimi që shfaqet ndërmjet një Shteti dhe një depozituesi përsa i përket kryerjes së funksioneve të këtij të fundit, depozituesi do ta çojë çështjen në vëmendjen e Shteteve nënshkruese dhe kontraktuese ose, aty ku është e përshtatshme, te organi kompetent të organizatës ndërkombëtare të interesuar.

Neni 78
Njoftimet dhe komunikimet

Përveç rasteve kur traktati ose kjo Konventë parashikojnë ndryshe, çdo njoftim ose komunikim që do të bëhet në bazë të kësaj Konvente:

a) do t'i transmetohet drejtpërsëdrejti Shteteve për të cilët ai është bërë, në qoftë se nuk ka depozitues ose në qoftë se ka, këtij të fundit;

b) do të konsiderohet se është bërë nga Shteti në fjalë vetëm në bazë të marrjes së tij nga Shteti, të cilit i është transmetuar ose, siç mund të jetë rasti, në bazë të marjes së tij nga depozituesi;

c) do të konsiderohet se, është marrë nga Shteti për të cilin është bërë vetëm në rastet kur Shteti i fundit është informuar nga depozituesi në përputhje me nenin 77, paragrafi 1 (e).

Neni 79
Ndreqja e gabimeve në tekstet ose në kopjet e vërtetuara të traktateve

1. Aty ky, pas njëjtësimit të tekstit të traktatit, Shtetet nënshkruese dhe kontraktuese kanë rënë dakord se ai përmban një gabim, gabimi, në qoftë se ato nuk vendosin në bazë të mjeteve të tjera të korrektimit, do të ndreqet:

a) duke pasur ndreqjen e saktë të bërë në tekst dhe duke shkaktuar që korrektimi të jetë filluar nga përfaqësuesit e duhur;

b) duke zbatuar ose shkëmbyer një instrument ose instrumente që bëjnë të njohur ndreqjen, e cila është rënë dakord të bëhet, ose

c) duke zbatuar një tekst të korrektuar të të gjithë traktatit me të njëjtën procedurë si në rastin e tekstit origjinal.

2. Atëherë kur traktati ka një depozitues, ky i fundit do të njoftojë Shtetet nënshkruese dhe kontraktuese në lidhje me gabimin dhe me propozimin për ta ndrequr atë dhe do të specifikojë një afat të përshtatshëm brenda, të cilit mund të ngrihet kundërshtimi në lidhje me ndreqjen e propozuar. Në qoftë se në kohën e mbarimit të afatit:

a) nuk është ngritur ndonjë kundërshtim, depozituesi do të bëjë dhe do të fillojë ndreqjen në tekst dhe do të bëjë një procesverbal në lidhje me ndreqjen e tekstit dhe t'ia komunikojë një kopje të tij palëve dhe Shteteve që kanë të drejtë të jenë palë në traktat;

b) është ngritur një kundërshtim, depozituesi do t'ua njoftojë atë Shteteve nënshkruese dhe kontraktuese.

3. Rregullat e paragrafeve 1 dhe 2 aplikohen gjithashtu në rastet kur teksti është njëjtësuar në dy ose më tepër gjuhë dhe bëhet e qartë që ka një mungesë përputhje për të cilën Shtetet nënshkruese dhe kontraktuese bien dakord që të ndreqet.

4.Teksti i ndrequr zëvendëson tekstin që kishte të meta ab initio (nga e para), me përjashtim të rasteve kur Shtetet nënshkruese dhe kontraktuese vendosin ndryshe.

5. Ndreqja e një traktati, që është regjistruar do t'i njoftohet Sekretariatit të Kombeve të Bashkura.

6. Aty ku është gjetur një gabim në një kopje të vërtetuar të traktatit, depozituesi do të përpilojë një procesverbal, i cili specifikon ndreqjen dhe do t'i komunikoj një kopje të tij Shteteve nënshkruese dhe kontraktuese.

PJESA VIII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 81
Nënshkrimi

Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim për të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe për çdonjërën prej agjencive të specializuara të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike ose palët në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, dhe për çdo Shtet tjetër të ftuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, për t'u bërë palë në Konventë, si më poshtë: deri më 30 Nëntor 1969, pranë Ministrisë Federale të Punëve të Jashtme të Republikës së Austrisë, dhe

më pas, deri në 30 Prill 1970, pranë Selisë së Kombeve të Bashkuara, Nju Jork.

Neni 82
Ratifikimi

Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 83
Aderimi

Kjo Konventë do të mbetet e hapur për aderim për çdo Shtet, që bën pjesë në kategoritë e përmendura në nenin 81. Instrumentet e aderimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 84
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi pas tridhjetë ditësh nga data e depozitimit të instrumentit të tridhjetepestë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për seicilin Shtet që e ratifikon ose aderon në Konventë pas dorëzimit të instrumentit të tridhjetepestë të ratifikimit ose aderimit, Konventa do të hyjë në fuqi pas tridhjetë ditësh nga depozitimi prej këtij Shteti të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 85
Tekstet autentike

Origjinali i kësaj Konvente, nga të cilët tekstet në gjuhën kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle janë autentike, do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të personave nënshkrues dhe fuqiplotë, të autorizuar në mënyrën e duhur nga Qeveritë e tyre, kanë nënshkruar këtë Konvetë.

Bërë në Vjenë, më 23 Maj, 1969.

ANEKS

1. Do të përpilohet një listë pajtuesish të përbërë nga juristë të kualifikuar dhe që do të ruhet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Në këtë kuptim, çdo Shtet, i cili është Anëtar i Kombeve të Bashkuara ose një palë e kësaj Konvente do të ftohet të emërojë dy pajtues dhe emrat e personave të emëruar në këtë mënyrë do të përbëjnë listën. Periudha e detyrës së një pajtuesi, duke përfshirë atë të ndonjë pajtuesi të emëruar për të plotësuar një vend bosh, do të jetë pesë vjet dhe mund të përsëritet. Një pajtues periudha e detyrës së të cilit mbaron, do të vazhdojë të përmbushë çdo funksion për të cilin ai do të jetë zgjedhur në bazë të paragrafit të mëposhtëm.

2. Kur i është bërë një kërkesë Sekretarit të Përgjithshëm në mbështetje të nenit 66, Sekretari i Përgjithshëm do ta paraqesë konfliktin përpara një komisioni pajtimi të formuar si më poshtë:

Shteti ose Shtetet që përbëjnë një prej palëve në konflikt do të emërojnë:

a) një pajtues me shtetësinë e atij Shteti ose të seicilit prej Shteteve, të cilët mund ose nuk mund të zgjidhen nga lista e parashikuar në paragrafin 1; dhe

b) një pajtues që nuk ka shtetësinë e atij Shteti ose të secilit prej Shteteve, të cilët do të zgjidhen nga lista.

Shteti ose Shtetet që përbëjnë palën tjetër në konflikt do të emërojnë dy pajtues në të njëjtën mënyrë. Të katër pajtuesit e zgjedhur nga palët do të emërohen brenda 60 ditëve pas datës së marrjes së kërkesës nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të bashkuara.

Të katër pajtuesit, brenda 60 ditëve, pas datës së emërimit të fundit të tyre, do të caktojnë pajtues të pestë të zgjedhur nga lista, i cili do të jetë si kryetar.

Në qoftë se emërimi i kryetarit ose i çdo pajtuesi tjetër nuk është bërë brenda periudhës së përshkruar më sipër për një emërim të tillë, ai do të bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm brenda gjashtëdhjetë ditësh nga data e mbarimit të kësaj periudhe. Emërimi i kryetarit mund të bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm ose nga lista ose prej anëtarëve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare. Secila prej periudhave brenda të cilave duhet të bëhen emërimet mund të zgjatet me anë të marrëveshjes midis palëve në konflikt.

Çdo vend bosh do të plotësohet në mënyrën e përshkruar për fillimin e emërimit.

3. Komisioni i Pajtimit do të përcaktojë procedurën e tij. Komisioni, me pëlqimin e palëve në konflikt, mund të ftojë çdo palë të traktatit, që t'i paraqesë atij pikëpamjet e saj me shkrim ose gojarisht. Vendimet dhe rekomandimet e Komisionit do të merren me shumicën e votave të të pesë anëtarëve.

4. Komisioni mund të tërheqë vëmendjen e palëve në konflikt që të marrin çdo masë që mund të lehtësojë arritjen e një zgjidhjeje miqësore.

5. Komisioni do të dëgjojë palët, shqyrtojë pretendimet dhe kundërshtimet, dhe do t'u bëjë propozime palëve me qëllim që të arrihet një zgjidhje miqësore e çështjes.

6. Komisioni do të raportojë brenda dymbëdhjetë muajve nga formimi i tij. Raporti i tij do të depozitohet pranë Sekretariatit të Përgjithshëm dhe do t'u transmetohet palëve në konflikt. Raporti i komisionit, i cili përfshin përfundimet e deklaruara që kanë të bëjnë me fakte ose çështje ligjore, nuk do të jetë i detyrueshëm për palët dhe do të ketë vetëm karakter rekomandues që i paraqitet për t'u vlerësuar nga palët me qëllim që të lehtësojë arritjen e një zgjidhjeje paqësore të konfliktit.

7. Sekretari i Përgjithshëm do t'i sigurojë Komisionit ndihmën dhe lehtësitë që mund të kërkohen prej tij. Shpenzimet e Komisionit do të mbulohen nga Kombet e Bashkuara.

V E N D I M
Nr.634, datë 30.11.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET NR.357, DATË 7.7.2000, NR.511, DATË 21.9.2000, NR.567, DATË 23.10.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, DHE NË PLANIN E SHPRONËSIMEVE PËR VITIN 2000, PËR MINISTRINË E TRANSPORTIT, NË OBJEKTET ME FINANCIM TË HUAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 7 dhe 9, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.357, datë 7.7.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2000 për Ministrinë e Transportit", në zërin "shpronësime, për objektet me financim të huaj", pasqyra e fondeve buxhetore shtesë për vitin 2000 në zërin "shpronësime", ndryshohet sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në vendimin nr.511, datë 21.9.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2000, për Ministrinë e Transportit", tabela për fondet shtesë për shpronësime, TVSH dhe kosto lokale, sipas objekteve që financohen nga donatorë të huaj, ndryshohet sipas pasqyrës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në vendimin nr.567, datë 23.10.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2000, për Ministrinë e Transportit", në zërat "shpronësime dhe TVSH, për objektet me financim të huaj" ndryshohet sipas pasqyrës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Nga fondi prej 4 milionë lekësh, i planifikuar për vitin 2000 për shpronësimet e segmentit rrugor Librazhd, të zbriten 3 milionë lekë.

5. Diferenca e krijuar nga këto ndryshime të rishpërndahet sipas pasqyrës nr.4 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

PASQYRA NR.1
PËR NDRYSHIMET E FONDEVE TË V.K.M. NR.357, DATË 7.7.2000 PËR SHPRONËSIMET

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Fondi shtesë sipas V.K.M. Nr.357, dt.7.7.2000 për shpronësimet	Fondi i ndryshuar për shpronësime	Diferenca
1.	Segmenti Vorë-Sukth	58 000	58 000	0
2.	Segmenti Rrogozhinë-Elbasan	162 000	162 000	0
3.	Segmenti Kapshticë- Korçë	60 000	56 700	3300
4.	Segmenti Kakavijë-Gjirokastër	50 000	50 000	0
5.	Segmenti Sukth-Durrës	30 000	30 000	0
6.	Segmenti Durrës-Rrogozhinë	20 000	20 000	0
7.	Segmenti Rrogozhinë-Lushnje	20 000	20 000	20 000
	Gjithsej	400 000	376 700	23 300

PASQYRA NR.2
PËR NDRYSHIMET E FONDEVE TË V.K.M. NR.511, DATË 21.9.2000 PËR SHPRONËSIMET
Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Fondi shtesë sipas V.K.M. Nr.511, dt.21.9.2000 për shpronësimet	Fondi i ndryshuar për shpronësime	Diferenca
1.	Lidhja e rrugës së re në Shullaz (Milot)	2100	21 00	0
2.	Segmenti Vorë-Sukth	27 000	18 000	9000
3.	Sukth-Durrës	30 000	55 00	24 500
4.	Rrogozhinë-Elbasan	13 000	13 000	0
5.	Korçë-Kapshticë	30 000	0	30 000
6.	Kakavijë-Gjirokastër	30 000	18 000	12 000
7.	Durrës-Rrogozhinë	17 900	1400	16 500
8.	Milot-Lezhë	4500	0	4500
	Gjithsej	154 500	58 000	96 500

PASQYRA NR.3
PËR NDRYSHIMET E FONDEVE TË V.K.M. NR.567, DATË 23.10.2000 PËR SHPRONËSIMET

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Fondi shtesë sipas V.K.M. Nr.357, dt.7.7.2000 për shpronësimet	Fondi i ndryshuar për shpronësime	Diferenca
1.	Sukth-Durrës	20 000	20 000	0
2.	Rrogozhinë-Lushnje	20 000	0	20 000
3.	Kakavijë-Gjirokastër	20 000	0	20 000
4.	Rrogozhinë-Elbasan	10 000	0	10 000
5.	Korçë-Kapshticë	10 000	0	10 000
	Gjithsej	80 000	20 000	60 000

PASQYRA NR.4
PËR RISHPËRNDARJEN E FONDEVE TË SHPRONËSIMEVE NË TVSH DHE KOSTO LOKALE PËR VITIN 2000

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Fondi shtesë për TVSH	Fondi shtesë për kosto lokale	Totali
1.	Durrës-Rrogozhinë	27 500		27 500
2.	Rrogozhinë-Lushnje	25 000		25 000
3.	Rrogozhinë-Elbasan	25 000		25 000
4.	Durrës-Sukth	25 000		25 000
5.	Vorë-Sukth	25 000		25 000
6.	Librazhd-Qukës	30 300	25 000	55 300
	Gjithsej	157 800	25 000	182 800

V E N D I M
Nr.636, datë 30.11.2000

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.328, DATË 26.6.1995, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN EKONOMIK FINANCIAR TË NJËSISË SË TRANSPORTIT MJEKËSOR ME HELIKOPTERË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës" dhe të neneve 2 dhe 6, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin

dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 2 e vendimit nr.328, datë 26.6.1995, të Këshillit të Ministrave ndryshon si vijon:

"2.a) Për kategorinë e personelit të parashikuar në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, deri në 250 për qind mbi bazën bazë.

b) Për kategorinë e personelit të parshikuar në shkronjat "c" dhe "d" deri në 150 për qind mbi pagën bazë.

c) Për kategorinë e personelit të parashikuara në shkronjën "e" deri në 50 për qind mbi pagën bazë.".

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti që do të miratohet për vitin 2001 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe të fillojnë nga data 1 janar 2001.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.637, datë 30.11.2000

PËR MBYLLJEN E DISA MINIERAVE TË HEKURNIKELIT NË RRETHET POGRADEC DHE LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998, "Për strategjinë e priviatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", ndryshuar me ligjin nr.8582, datë 23.2.2000, dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të mos vlerësohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë dhe të kalojnë në mbyllje ndërmarrjet minerare dhe minierat e hekurnikelit:

- Ndërmarrja minerare e hekurnikelit, Guri i Kuq — rrethi Pogradec
- Miniera e hekurnikelit, Prrenjas — rrethi Librazhd
- Miniera e nikelsilikatit, Katjel — rrethi Librazhd
- Sektori minierar Bushtricë (traverbanku H-385) — rrethi Librazhd

2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, brenda muajit shkurt 2001, të përfundojë projektet, ndërsa mbyllja e tyre të përfundojë brenda vitit 2001.

3. Shpenzimet për mbylljen e minierave të përballohen nga fondi buxhetor, në zërin "Konservim dhe mbyllje miniere", i cili do të programohet në vitin 2001, për Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Makineritë, pajisjet, materialet dhe objektet sipërfaqësore të privatizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, ose të dërgohen në minierat e tjera, të cilat e vazhdojnë veprimtarinë.

5. Punonjësit, të cilët deri më datën 1.1.2000 kanë qenë në marrëdhënie pune dhe që do të jenë të tillë deri në çastin e mbylljes së minierave, të trajtohen duke nisur nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për 1 (një) vit me pagën minimale në shkallë vendi. Kjo pagesë ndërpritet për punonjësit të cilët kryejnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit ose të vetëpunësimit, brenda periudhës së trajtimit në këtë pagesë.

6. Periudha 1 (një) vjeçare t'u njihet punonjësve, që do të dalin të tepërt dhe do të trajtohen sipas këtij vendimi, si vjetërsi pune për efekt pensioni dhe të shënohet si e tillë në librezën e punës.

7. Fondi prej 22 milionë lekësh për trajtimin e punonjësve që humbasin vendin e punës të përballohet nga fondi buxhetor që do të miratohet për vitin 2001 për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve

Sociale.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 638, datë 30.11.2000

PËR MBYLLJEN E DISA MINIERAVE TË KROMIT NË RRETHET TROPOJË, MAT, BULQIZË, POGRADEC DHE LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998, "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", ndryshuar me ligjin nr.8582, datë 23.2.2000, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të mos i vlerësojë si pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë objektet e industrisë nxjerrëse të kromit, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet vendimit, dhe të mos lejojë që t'i nënshtrohet procesit të privatizimit ose të likuidimit.

2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, brenda muajit mars 2001, të fillojë procedurat e privatizimit dhe të hartojë projektet e mbylljes së këtyre minierave, ndërsa mbyllja e tyre të përfundojë brenda vitit 2001.

3. Shpenzimet për mbylljen e minierave të përballohen nga fondi buxhetor, në zërin "Konservim dhe mbyllje miniere", i cili do të programohet në vitin 2001, për Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Makineritë, pajisjet, materialet dhe objektet sipërfaqësore të privatizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi ose të dërgohen ne minierat e tjera, të cilat e vazhdojnë veprimtarinë.

5. Punonjësit, të cilët deri më datën 1.1.2000, kanë qenë në marrëdhënie pune dhe që do të jenë të tillë deri në çastin e mbylljes së minierave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të trajtohen, për 1(një) vit, duke u nisur nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, me pagën minimale në shkallë vendi. Kjo pagesë ndërpritet për punonjësit të cilët kryejnë veprimtari ekonomike, në formën e punësimit ose të vetëpunësimit brenda periudhës së trajtimit me këtë pagesë.

6. Periudha 1 (një) vjeçare t'u njihet punonjësve, që përfitojnë nga ky vendim si vjetërsi në punë për efekt pensioni dhe të shënohet si e tillë në librezën e punës.

7. Fondi prej 7 700 000 (shtatë milionë e shtatëqind mijë) lekësh për trajtimin e punonjësve që humbasin vendin e punës, të përballohet nga fondi buxhetor që do të miratohet për vitin 2001 për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

TABELA E OBJEKTEVE TË KROMIT TË CILAT DO TË MBYLLEN DHE PRIVATIZOHEN

Tabela Nr.1

I. Miniera e Kromit Batër	Bulqizë
1. Vendburimi Lugu i Qershisë	
2. “ Maja e Lugut	
3. “ Lugu i Thellë	
4. “ Krastë (Dishanteria e gal.1 deri gal.4)	
5. “ Krastë (Gal.9, 10, 11, 12, 13)	
II. Miniera e Kromit Klos	Mat
1. Galeria Nr.7 Shkallë (Thellësia e vb. Kromit Shkallë)	
2. Vendburimi Maja e Kurorës	
3. “ “ Liqeni i Dhive	
4. “ “ Manazdreni Perëndimor	
5. “ “ Manazdreni Lindor	
6. “ “ Studenti Cruj	
7. “ “ Maja e Burrelit	
III. Miniera Tërnovë	Bulqizë
1. Galeria Nr.1 Tërnovë	
2. Vendburimi në Galerinë Nr.1	
3. “ “ Pylli i Zi Trupi kryesor	
4. “ “ Livadhi i Dashit	
IV. Miniera Selishtë	Dibër
1. Vendburimi Hurdha e Tollës (Rrethi Mirditë)	
2. “ “ Selishta Veriore	
3. “ “ Selishta Jugore	
4. “ “ Fush Shtrungzë	
5. “ “ Kodra e Lëmuar	
VI. Miniera Kam Tropojë	Tropojë
1. Vendburimi Shpati i Vishisë	
2. “ “ Zogaj 1 560-600	
3. “ “ Zogaj 1 480-560	
4. “ “ Zogaj 3 (Hija e Bushit)	
5. “ “ Çabrat 1	
6. “ “ Tplan Perëndimore	
7. “ “ Ragam 1	
8. “ “ Ragam 2	
9. “ “ Ragam 3	
10. Vendburimi Kepenek	
11. “ “ Qaf Prush	
12. “ “ Livadhi i Kokës 1	
13. “ “ Livadhi i Kokës 2	
14. “ “ Zgjeç 1	
15. “ “ Maç	
16. “ “ Çorraj -Shkallë	
17. “ “ Skantinat	
VII. Minierat e tjera	Librazhd-Pogradec
1. Vendburimi Guri i Pishkashit	
2. “ “ Menik	
3. “ “ Memelisht	
4. “ “ Bushtricë	

VIII. Njësia eksport-import Durrës
1. Impianti i rërës

V E N D I M
Nr. 639, datë 30.11.2000

PËR RRITJEN E SHTESËS SË VËSHTIRËSISË NË SHËRBIMIN E EFEKTIVAVE NË KOMPANINË OPERATIVE DHE DEGËN E RUAJTJES E SIGURIMIT TË OBJEKTEVE, NË BATALIONIN E PARË, TË DYTË, TË TRETË DHE NË BATALIONIN SPECIAL, NË GARDËN E REPUBLIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 21 e 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Funksionet operuese në strukturë të Gardës së Republikës të trajtohen me të njëjtën pagë bazë (Për klasë) me funksionet analoge në sistemin e Ministrisë së Rendit Publik, ndërsa shtesa për vështirësi shërbimi të jetë:

a. Në masën deri në 300 për qind për funksionet operuese në kompaninë operative.

b. Në masën deri në 150 për qind për funksionet operuese, që merren me ruajtjen dhe mbrojtjen e institucioneve të larta të shtetit, për funksionet operuese në degën e ruajtjes e të sigurimit të objekteve të rëndësisë së veçantë, në batalionin e parë, në batalionin e dytë, në batalionin e tretë dhe në batalionin special.

2. Klasifikimi i funksioneve dhe masa e shtesës të përcaktohen nga ministri i Rendit Publik.

3. Funksionet, që trajtohen sipas këtij vendimi, përfitojnë dhe trajtimet e tjera si ushtarakë, me përjashtim të mbikohës së punës e të shërbimit.

4. Për efekt të zbatimit të këtij vendimi në buxhetin e vitit 2000, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik, shtohet një fond prej 7 273 600 (shtatë milionë e dyqindeshtatëdhjetetre mijë e gjashtëqind) lekësh.

5. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.12.2000

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 640, datë 30.11.2000

PËR RRITJEN E PAGESËS KALIMTARE TË USHTARAKËVE NË REZERVË (LIRIM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Shtetëror"; ndryshuar me ligjin nr.8521, datë 30.7.1999, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8087, datë 13.3.1996", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagesa kalimtare që marrin ushtarakët në rezervë (lirim), të caktuara deri më datë 30.6.2000, (përfshirë edhe kjo datë), në mbështetje të shkronjës "b", të nenit 10, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, së bashku me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 10 për qind.

2. Përfitojnë nga kjo rritje ushtarakët në rezervë (lirim), të strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror.

3. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2000, për institucionet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare që nga data 1.7.2000.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë:

Thimjo Kondi	Kryetar
Bashkim Caka	Anëtar
Agron Lamaj	"
Vladimir Bineri	"
Artan Hoxha	"
Natasha Sheshi	"
Zamir Poda	"
Nikoleta Kita	"
Valentina Kondili	"
Metush Saraçi	"
Tefta Zaka	"
Ylvi Myrtja	"
Vangjel Kosta	"
Petrit Plloçi	"
Vladimir Metani	"
Vitore Tusha	"

në datën 09.10.2000 dhe 27.10.2000 në Këshill shqyrtuan çështjen civile nr. 1215/1 që u përket:

KËRKUES:Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut,
përfaqësuar nga av. Krenar Loloçi.

OBJEKTI I KËRKESËS: Plotësim i vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 643, datë 11.05.2000, në bazë të nenit 313 të Kodit të Procedurës Civile.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në çështjen me paditësa Kreshnik Angoni, Adrian Angoni, Fatmir Duli, të paditur Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut, me vendimin nr. 643, datë

11.05.2000 kanë vendosur:

Prishjen e vendimit nr. 3844, datë 29.07.1997, të gjykatës së rrethit Tiranë, të vendimit nr. 2983, datë 09.12.1997 të gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 15/1, datë 15.02.1999 të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë dhe pushimin e gjykimit të çështjes për kërkimin e qirasë.

Lënien në fuqi të vendimeve të mësipërme për lirimin e dorëzimin e ambienteve.

Pala e paditur, Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut ka paraqitur një kërkesë në të cilën parashtron:

Kolegjet e Bashkuara kanë vendosur prishjen e vendimeve dhe pushimin e gjykimit të çështjes për kërkimin e qirasë, por kanë ometuar të shprehen për shumën e qirasë, që në bazë të vendimeve të mësipërme i është ndaluar palës së paditur e që duhet t'i kthehet asaj.

Meqenëse Kolegjet e Bashkuara kanë vendosur pushimin e gjykimit të çështjes përsa i përket lëshimit të qirasë, ato gjithashtu duhet të shpreheshin edhe për rregullimin e pasojave që kishin sjellë vendimet e mësipërme të prishura.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pas relatimit të çështjes nga gjyqtarët Thimjo KONDI dhe Agron LAMAJ, e pasi e biseduan atë në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Pala e paditur pretendon se Kolegjet e Bashkuara në vendimin nr. 643, datë 11.05.2000 kanë ometuar të zgjidhin pasojat e prishjes së vendimeve të mëparshme të dhëna për këtë çështje, prandaj ka kërkuar të plotësohet ky vendim duke vendosur detyrimin e Zyrës së Përmbarimit t'u kthejë shumat përkatëse që u ka marrë në ekzekutimin e vendimeve që më vonë kanë rezultuar të pabazuara në ligj.

Duke iu referuar kërkesës për plotësimin e vendimit nr. 643, datë 11.05.2000, sipas nenit 313 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se në këtë rast nuk ka vend për plotësimin e vendimit të dhënë prej tyre.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi kanë arritur në përfundimin se midis palëve nuk është lidhur ndonjë kontratë qiraje dhe për këtë shkak padia me objekt kërkim qiraje nuk mund të ngrihej, kanë vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave të të tre shkallëve për këtë çështje dhe pushimin e gjykimit të saj.

Kjo zgjidhje nënkupton që shumat e dhëna nga pala e paditur në ekzekutim të vendimeve, që përfundimisht janë prishur me një vendim përfundimtar dhe të formës së prerë, duhet t'i kthehen përsëri asaj. Kthimi duhet të bëhet nga Zyra e Përmbarimit, e cila ka filluar dhe ka në vazhdim procedimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim, gjersa në praktikë kanë lindur keqkuptime lidhur me mënyrën se si do të zgjidhen pasojat që rrjedhin prej ekzekutimit të një vendimi, i cili është prishur më pas me një vendim të formës së prerë, është e nevojshme që, në kuptim të nenit 314 të Kodit të Procedurës Civile, të bëhet nga vetë Kolegjet e Bashkuara sqarimi dhe interpretimi i vendimit nr. 643, datë 11.05.2000 të dhënë prej tyre, dhe, nëpërmjet vendimit që do të jepet për këtë qëllim, të ofrohet një zgjidhje e unifikuar për rastet e ngjashme të praktikës gjyqësore, sipas arsyetimit të mëposhtëm:

Në Kodin e Procedurës Civile të mëparshëm, në nenin 190/1 të tij parashikohej në mënyrë të shprehur se: "Kur vendimi i ri që jepet pas prishjes, është i ndryshëm nga vendimi i parë, i cili është ekzekutuar tërësisht ose pjesërisht personi që ka përfituar detyrohet të kthejë të gjitha përfitimet që ka marrë nga ekzekutimi i vendimit". Një dispozitë e tillë nuk ekziston më në Kodin e Procedurës Civile në fuqi, por kjo nuk do të thotë se nuk duhet të ekzistojë një zgjidhje e tillë e problemit edhe në këtë regjim juridik të ri. Sipas nenit 1/1 të Kodit të Procedurës Civile, "gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështje që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë". Pra, zgjidhja që duhet të jepet nuk mund të jetë e ndryshme nga zgjidhja që ofrohet në dispozitën e sipërcituar të Kodit të mëparshëm të Procedurës Civile. Shtrohet pyetja: A ekziston në Kodin e Procedurës Civile në fuqi ndonjë dispozitë konkrete që të japë një zgjidhje të tillë për raste të ngjashme? Duke iu referuar nenit 319/2 të Kodit Procedurës Civile, që parashikon rrjedhojat nga prishja e vendimit që është dhënë në ekzekutim të përkohshëm,

gjejmë këtë rregullim:

"Në rast se pas prishjes së vendimit të parë padia rrëzohet dhe vendimi merr formë të prerë, gjyqfituesi i parë detyrohet t'i kthejë palës tjetër gjithçka që ka marrë me ekzekutim të përkohshëm të vendimit të parë": Nëpërmjet interpretimit logjik të kësaj dispozite, konkludohet se zgjidhja e pasojave që vinë nga ekzekutimi i një vendimi të formës së prerë, i cili është prishur më pas me një vendim të formës së prerë.

Si konkluzion, **në të gjitha rastet kur vendimi i ri që jepet pas prishjes, është i ndryshëm nga vendimi i parë, i cili është ekzekutuar tërësisht ose pjesërisht, personi që ka përfituar detyrohet të kthejë të gjitha përfitimet që ka marrë nga ekzekutimi i vendimit.**

Kthimi i përfitimeve, si rregull, duhet të përcaktohet në vendimin e ri të formës së prerë që jepet pas prishjes së vendimeve të mëparëshme. Megjithatë, edhe në rastet kur në këtë vendim gjykata nuk shprehet në mënyrë eksplicite për rregullimin e pasojave që kanë ardhur nga ekzekutimi tërësisht apo pjesërisht i vendimit të padrejtë që është prishur më pas, zgjidhja në këtë mënyrë e pasojave është evidente. Zyra e Përmbarimit që e ka bërë ekzekutimin e plotë apo të pjesshëm të vendimit të padrejtë, që është prishur më pas, me kërkesën e gjyqfituesit, sipas procedurës që përcakton neni 511 i Kodit të Procedurës Civile, duhet të detyrojë përfituesin të kthejë të gjitha përfitimet e padrejta.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 314/1 të Kodit të Procedurës Civile dhe të nenit 17 të Ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë",

V E N D O S Ë N:

1. Interpretimin e vendimit nr. 643, datë 11.05.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mënyrën e parashtruar në pjesën parashikuese – arsyetuese të këtij vendimi.

Detyrimin e Zyrës së Përmbarimit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë t'i kthejë gjyqfituesit Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut të gjitha çfarë kanë përfituar paditësat nga ekzekutimi i vendimit nr. 3844, datë 29.07.1997 të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë e të vendimit nr. 2983, datë 09.12.1997 të gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Ky vendim për njehsimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jemi dakort me vendimin e shumicës për sa parashtrojmë:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar çështjen civile me paditës Kreshnik Angoni, Adrian Angoni e Fatmir Duli dhe të paditur Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut dhe me vendimin nr. 643 datë 11.5.2000 kanë vendosur: Prishjen e vendimeve përkatëse të Gjykatës së Rrethit Tiranë, të gjykatës së apelit Tiranë si dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes për kërkimin e qirasë.

Pala e paditur PBDNJ ka kërkuar plotësimin e vendimit në lidhje me rregullimin e pasojave përsa i përket shumës së qirasë meqenëse vendimi i parë është ekzekutuar.

Kërkimi nuk është i bazuar ligjërisht. Vendimi i pushimit është përfundimtar se i jep fund procesit gjyqësor, por nuk e zgjidh çështjen në themel (nenet 126 e 127 të Kodit të Procedurës Civile), prandaj Kolegjet e Bashkuara duhet të rrëzojnë kërkesën e paraqitur. Palët të drejtat e pretenduara mund t'i realizojnë secila me paraqitjen e kërkesëpadive përkatëse.

Anëtarë
Y.Myrtja
V.Kondili

Tiranë, më 27.10.2000
Nr.1215 i Regj.Themeltar
Nr. 1029 i Vendimit

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Bashkim Caka	Anëtar
Agron Lamaj	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“
Nikoleta Kita	“
Artan Hoxha	“
Natasha Sheshi	“
Valentina Kondili	“
Tefta Zaka	“
Vangjel Kosta	“
Petrit Plloçi	“
Perikli Zaharia	“
Zamir Poda	“
Ylvi Myrtja	“
Vitore Tusha	“

në seancën gjyqësore me dyer të hapura të datës 15.9.2000 morën në shqyrtim çështjen civile nr.850 që i përket:

PADITËS: Polikron Koço, banues në Tiranë, përfaqësuar nga av. Sofika Koço.

I PADITUR: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë në mungesë.

OBJEKTI: Anullimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.44, datë 21.01.1999, pika 7, në pjesën që ka vendosur paditësin, person të lidhur me shoqërinë “Gjallica” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Neni 5 i ligjit 8227, datë 30.7.1997.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.2, datë 14.7.1999, ka vendosur:

Pranimin e padisë pjesërisht, vetëm në favor të paditëses Sofika Koço, duke anulluar pjesërisht vendimin nr.44, datë 21.09.1999 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë vetëm përsa i përket pikës 1/8 të lidhjes bashkëngjitur këtij vendimi.

Rrëzimin e padisë për paditësin Polikron Koço.

Kundër vendimit të mësipërm ka ushtruar rekurs paditësi Polikron Koço duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimi i gjykatës vjen në kundërshtim me ligjin nr.8227, datë 30.7.1997, sepse nuk kam asnjë detyrim ndaj shoqërisë.

- Nga ekspertët që janë marrë me transparencën vërtetohet se nuk jam debitor.

Kolegji Civil i Gjykatë së Lartë, me vendimin e datës 28.6.2000 ka vendosur:

Kalimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara me qëllim që të përcaktohen kufinjtë e përcaktimit të saj në Gjykatën e Lartë.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relacionin e anëtarëve Ylvi Myrtja dhe Vitore Tusha, pasi dëgjuan av. Sofika Koço e cila kërkoi të prishej vendimi i gjykatës së Apelit dhe të pranohej padia e Polikron Koços, e pasi e biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Vendimi i gjykatës së Apelit është i bazuar në ligj, prandaj duhet të lihet në fuqi.

Ka rezultuar në gjykim se paditësi Polikron Koço ka qenë përkohësisht menaxher (administrator) i shoqërisë "Gjallica" sh.p.k, e cila ka ushtruar veprimtarinë e kundërligjshme të depozitimit të shumave në të holla nga publiku i gjerë me interesa të larta, në pamundësi për t'i kthyer, dhe që është cilësuar si skemë mashtruese piramidale.

Me vendimin e Këshillit të Ministrave. nr.44, datë 21.01.1999, pika 7, paditësi është deklaruar person i lidhur me shoqërinë huamarrëse, subjekt të kontrollit financiar. Këtë vendim e ka kundërshtuar paditësi me arsyetimin se është në kundërshtim me ligjin nr.8227, datë 30.7.1997.

Bazuar në nenin 5 të ligjit nr.8227, datë 30.07.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 19.05.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jo bankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë"", padia është shqyrtuar nga gjykata e Apelit e cila, mbështetur në nenin nr.465 të Kodit të Procedurës Civile, e ka shqyrtuar në themel çështjen dhe ka vendosur rrëzimin e padisë të Polikron Koços me arsyetimin se:"... fakti që paditësi ka qenë përkohësisht menaxher i Shoqërisë "Gjallica" sh.p.k sipas nenit 4/a të Ligjit nr.8227, datë 30.07.1997, mjafton që ai të shpallet person i lidhur me shoqërinë huamarrëse subjekt kontrolli".

Duke marrë shkas nga kjo çështje Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë të dalin me një vendim unifikues për arsye se:

Çështja objekt shqyrtimi fillon të gjykohet në gjykatën e apelit dhe jo në gykatën e rrethit siç është rregulli i përgjithshëm. Kodi i Procedurës Civile rregullon gjithë procedurën e gjykimeve të zakonshme dhe të posaçme që fillojnë të shqyrtohen në shkallën e parë duke i njohur palëve mjete ankimi ndaj vendimeve përkatëse në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë. Ligji nr.8227, datë 30.07.1997 përcakton një procedurë të posaçme përsa i takon gjykatës kompetente që shqyrton ankimin ndaj Vendimit të Këshillit të Ministrave që ka deklaruar personat e lidhur me shoqëritë huamarrëse. Ai përcakton gjykatën e apelit që të shqyrtojë këto ankime në themel. Duke qenë se kjo procedurë e posaçme shmang gjykimin e shkallës së parë, shtrohen disa probleme: së pari, a i mohohet palës e drejta kushtetuese e ankimit ndaj vendimit gjyqësor? Së dyti, cilat janë kufinjtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë?

Sipas nenit 442 të Kodit të Procedurës Civile, "Mjetet për t'u ankuar ndaj vendimeve të gjykatave janë : 1) Ankimi në gjykatën e apelit, 2) Rekursi në Gjykatën e Kasacionit (e Lartë), 3) Kërkesa për rishikim, si dhe 4) Kundërshtimi i të tretit."

Në rastin në shqyrtim përjashtohet mundësia e ushtrimit të ankimit në gjykatën e apelit, sepse vetë ligji e përcakton këtë gjykatë si gjykatë të juridiksionit fillestar.

Duke qenë kështu, mundësia e vetme është që vendimi i apelit të kundërshtohet në Gjykatën e Lartë. Rekursi është i vetmi mjet, që, sipas Kodit të Procedurës Civile, palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimeve të gjykatës së rrethit (gjyqësor) e të gjykatës së apelit në Gjykatën e Kasacionit (e Lartë), sipas rregullave të parashikuara në këtë kod (neni 112 i Kodit të Procedurës Civile).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 43 të saj parashikon se: "Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe".

Shtojmë që në fillim se rasti në shqyrtim nuk është nga ato për të cilat në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Pra, palës paditëse nuk mund t'i mohohet e drejta e ankimit kundër vendimit të gjykatës së apelit, e cila nuk mund të realizohet ndryshe, veçse duke kundërshtuar këtë vendim në Gjykatën e Lartë.

Kolegjet e Bashkuara me të drejtë ankimi kuptojnë të drejtën për të pasur me ligj mjete proceduriale për të kundërshtuar vendimin e gjykatës më të ulët në një gjykatë më të lartë.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se e drejta e personit për të pasur të paktën mundësinë e

një ankimi ndaj vendimit gyqësor të dhënë kundër tij, si e drejtë kushtetuese, garantohet nëpërmjet ushtrimit të rekursit në Gjykatën e Lartë.

Nga ana tjetër, shtrohet problemi nëse është e domosdoshme dhe e mundshme që Gjykata e Lartë, në këtë rast, të ndryshojë mënyrën e gjykimit dhe kufinjtë e shqyrtimit të çështjes. Pra, pyetja shtrohet nëse Gjykata e Lartë, edhe në këtë rast, do ta shqyrtojë çështjen duke iu përmbajtur shkaqeve që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, apo të veprojë si shkallë e dytë gjykimi (gjykate apeli). Në nenin 141 të Kushtetutës është përcaktuar se juridiksioni i Gjykatës së Lartë është, si rregull, juridiksion rishikues, por pranohet përjashtimisht në lëndë penale dhe juridiksioni fillestar për një numër shumë të kufizuar rastesh.

Kushtetuta, kur përcakton se Gjykata e Lartë ka juridiksion rishikues, nuk i parashikon konkretisht kufinjtë e shqyrtimit të çështjeve. Për rrjedhojë, ajo i lë hapësirën e nevojshme që këto kufinj të përcaktohen me ligj.

Një ligj që përcakton kufinj me të gjerë apo më të ngushtë të shqyrtimit të çështjeve të caktuara në Gjykatën e Lartë është në pajtim me Kushtetutën.

Në rastin në shqyrtim ligji nr.8227, datë 30.07.1997 nuk ka përcaktuar rregulla të veçanta të ankimit ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit dhe as ndonjë procedurë të veçantë për gjykimin e këtyre çështjeve në Gjykatën e Lartë. Gjersa ky ligj nuk ka përcaktuar kufinj të ndryshëm gjykimi në Gjykatën e Lartë për këtë kategori çështjesh, konkludohet se kufijtë nuk mund të jenë të ndryshëm nga ato që përcakon Kodi i Procedurës Civile. Pra, do të zbatohet procedura e zakonshme e gjykimit në Gjykatën e Lartë e rregulluar në Kodin e Procedurës Civile, për shkaqe që parashikon ky kod në nenin 472 të tij.

Si përfundim, **pavarësisht nga kufinjtë e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë të përcaktuara me ligj, palës në gjykim nuk i mohohet e drejta kushtetuese për të ushtruar të paktën një ankim kundër vendimit gjyqësor në një gjykatë më të lartë.**

Përsa i përket themelit të çështjes në shqyrtim Kolegjet e Bashkuara çmojnë se ajo është zgjidhur në pajtim me ligjin.

Me të drejtë gjykata e apelit e ka shqyrtuar çështjen në themel. Këtë mundësi ia lejon neni 465 i Kodit të Procedurës Civile, i cili e lejon këtë gjykatë që, edhe pse gjykon, si rregull, si shkallë e dytë, të përsërisë tërësisht apo pjesërisht hetimin gjyqësor të kryer nga gjykata e shkallës së parë. Gjersa këtë të drejtë kjo gjykatë e ka kur gjykon si shkallë e dytë, aq më tepër nuk mund t'i kufizohet ajo në rastet kur ligji i njeh juridiksionin fillestar.

Ndërsa, përsa i përket interpretimit të ligjit ajo s'mund të ketë asnjë kufizim.

Shkaku i ngritur në rekurs nga paditësi se gjykata e apelit nuk ka zbatuar drejt ligjin nr. 8227, datë 30.07.1997, sepse ai nuk është debitor i Shoqërisë "Gjallica" sh.p.k dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të shpallet person i lidhur me shoqërinë huamarrëse dhe as të më publikohet emri në Fletoren Zyrtare, nuk qëndron.

Në kuptim të neni 4 të ligjit nr.8227, datë 30.07.1997, persona të lidhur me shoqërinë huamarrëse nuk janë vetëm ata që kanë marrë në mënyrë direkte dhe/ose indirekte mjete financiare dhe nuk i kanë shlyer, por edhe persona që në mënyrë direkte ose indirekte kanë marrë pjesë në drejtimin e administrimin e subjektit të kontrollit.

Siç është pranuar nga gjykata e apelit rezulton se paditësi Polikron Koço ka qenë për një periudhë menaxher (administrator) i Shoqërisë "Gjallica" sh.p.k Kolegjet e Bashkuara çmojnë, se pavarësisht nga shlyerja e detyrimit, paditësi mbetet person i lidhur me Shoqërinë "Gjallica" sh.p.k., për shkak se ai ka pasur funksione drejtuese në të, duke qenë administrator i saj.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.44 që ka shpallur personat e lidhur me shoqërinë "Gjallica" sh.p.k, nuk ka përcaktuar për paditësin ndonjë detyrim financiar.Qënia e paditësit në listë, i shpallur si person i lidhur me këtë shoqëri është për shkakun që parashikon neni 4, paragrafi 7, i ligjit 8227, datë 30.7.1997 sipas të cilit ".... një person i lidhur me subjektin e kontrollit nënkupton çdo person juridik apo fizik, më poshtë do të quhet "person i lidhur", nëse:

... ai është i lidhur në mënyrë direkte ose indirekte me drejtimin e subjektit të kontrollit".

Nisur nga sa më sipër me të drejtë gjykata e apelit e ka rrëzuar padinë e Polikron Koços, pasi shkaku ligjor për qënien person i lidhur qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 141 paragrafi i dytë i Kushtetutës, në nenin 14 pika "c" dhe 17 pika "a" e Ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë", në nenin 485/a të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S Ë N:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.2, datë 14.7.1999 të Gjykatës së Apelit, Tiranë.
2. Ky vendim për njehsim të praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIM PARALEL

Çështja u tërhoq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara për të orientuar e udhëhequr praktikën gjyqësore për zbatimin e njëllojtë dhe të përpiktë të normave të së drejtës materiale e proceduriale, jo vetëm " lidhur me mënyrën e shqyrtimit Çështjes në Gjykatën e Lartë", por edhe "lidhur me mënyrën e shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit".

Objekti i çështjes në gjykim është shfuqizimi pjesërisht i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.44, datë 21.1.1997. Këshilli i Ministrave, vendimin e tij të mësipërm e ka nxjerrë në bazë të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215 datë 9.5.1997". "Për kontrollin financiar të personave juridikë jo bankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë"". Në bazë të këtij vendimi, paditësi Polikron Koço është deklaruar si person i lidhur me shoqërinë tregtare "Gjallica". Paditësi pretendon se nuk ka asnjë detyrim ndaj shoqërisë "Gjallica". Gjykata e apelit arsyeton se nga provat e shyrtuara, rezulton se paditësi ka qenë përkohësiht menaxher i shoqërisë. Për këtë, sipas nenit 4 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 është shpallur si person i lidhur me shoqërinë. Mbi faktet e provat që janë paraqitur nga palët gjatë procesit gjyqëor është vërtetuar se gjatë periudhës 27.7.1994 deri me 16.10.1996 ai ka marrë në pesë raste honorare në shumën e përgjithshme 255.000 $ për punë të ndryshme të bëra në shoqërinë tregtare. Sipas paragrafit të fundit të nenit 4 të ligjit nr.8227 me të drejtë është konsideruar nga gjykata e apelit Tiranë, "person i lidhur" me subjektin e kontrollit. Në këtë kuadër vendimi i gjykatës së apelit Tiranë nr.2, datë 14.7.1999 është i drejtë.

Sipas nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Përmendja e "dispozitave ligjore, në të cilat bazohet vendimi"i gjykatës, është kërkesë e domosdoshme e nenit 310/II/3 të Kodit të Procedurës Civile. Këtë detyrim ligjor gjykata e apelit Tiranë nuk e ka zbatuar. Në vendimin nr.2, datë 14.7.1999 të gjykatës së apelit Tiranë (vendimi i rekursuar) nuk citohet asnjë dispozitë proceduriale ku është mbështetur gjykata.

Ligji nr.8227, datë 30.07.1997 i cituar më sipër është një ligj material por në të ka edhe dispozita proceduriale. Kështu ligji përcakton rastet: a) kur mundet të merret vendimi nga Këshilli i Ministrave, b) si ankimohet ky vendim, c) juridiksioni fillestar gjyqësor që shqyrton ankimin kundër vendimit të Këshillit të Ministrave, d) afatet e shqyrtimit deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Këto lloj çështjesh, sipas ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 gjykohet direkt në gjykatën e apelit. Për shqyrtimin e këtyre çështjeve ligjvënësi ka parashikuar afate shumë të shkurtra. Sipas nenit 5 të ligjit personi i deklaruar i lidhur, ka të drejtë, që brenda 5 ditëve nga publikimi i vendimit të Këshillit të Ministrave të bëjë ankim në gjykatën e apelit. Gjykata e apelit duhet të shqyrtojë çështjen brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit. Nga dispozita e cituar më sipër rezulton se ligjvënënsi ka parashikuar si juridiksion fillestar gjykatën e apelit.

Dihet që juridiksioni është e drejta e organit shtetëror për të zgjidhur çështjet që përfshihen në funksionet e tyre, duke zbatuar në çdo rast ligjin që u njeh këtë të drejtë. Me juridiksion fillestar duhet kuptuar gjykimi për herë të parë apo gjykim në themel, që si rregull bëhet nga gjykatat e shkallës së parë. Juridiksioni fillestar i gjykatës së apelit, parashikuar nga ligji nr.8227, datë 30.7.1997 bëhet një përcaktim i ndryshëm dhe konkretisht: personi i prekur prej vendimit të Këshillit të Ministrave ka të drejtë që brenda pesë ditëve të publikimit të këtij vendimi të bëjë ankim në gjykatën e apelit duke argumentuar dhe kërkuar që ky vendim është marrë në kundërshtim me këtë ligj.

Juridiksioni fillestar i gjykatave të apelit i parashikuar nga neni 5 i ligjit nr.8227 ka nevojë të

zbërthehet e të shpjegohet më konkretisht: Si duhet të konsiderohet në këto raste gjykata e apelit si gjykatë e shkallës së parë apo jo, kufinjtë e shqyrtimit, normat proceduriale që do të zbatohen gjatë gjykimit, si do të konsiderohet vendimi që merret nga gjykata e apelit dhe si do të ankimohet ky vendim në një gjykatë më të lartë dhe a do të seleksionohet ankimi në përputhje me nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile. Pyetjet e shtruara për zgjidhje më sipër nuk gjejnë zgjidhje në ligjin "Për kontrollin financiar të personave juridikë jo bankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë".

Siç e cituam më sipër, në ligj sanksionohet vetëm: 1. Afati i brenda të cilit duhet të paraqitet ankimi, 2. Gjykata ku paraqitet ankimi, 3. afati i shqyrtimit të ankimit. Pyetjet e tjera nuk gjejnë zgjidhje në këtë ligj, ata gjejnë zgjidhje në Kodin e Procedurës Civile.

Konkretisht, gjykata e apelit është gjykata e parë, që i gjykon këto çështje pa u shqyrtuar më parë në gjykatën e shkallës së parë siç është rruga e zakonshme proceduriale gjykimit për çështje të tjera. Përsa i përket kufijve të shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit çmojmë se në zbatim të të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile, kjo gjykatë zhvillon të gjithë procedurën e gjykimit të çështjes nga fillimi e deri në fund duke mbajtur parasysh për aq sa janë të zbatueshme dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile. Më konkretisht, duhet theksuar, se në gjykimin e këtyre çështjeve gjykatat e apelit duhet të mbajnë mirë parasysh dispozitat e kreut të dytë të Kodit të Procedurës Civile ku parashikohen gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative (nenet 324-333 të Kodit të Procedurës Civile) me përjashtim të afatit për paraqitjen e ankimit (neni 328 të Kodit të Procedurës Civile). Afati për paraqitjen e ankimit kundër vendimit të Këshillit të Ministrave nuk është 30 ditë siç parashikon neni 328 i Kodit të Procedurës Civile, por 5 ditë siç parashikon neni 5 i ligjit nr.8227.

Gjithashtu duhet të mbahet mirë parasysh se për gjykimin e këtyre çështjeve, për natyrën dhe karakterin e tyre, zbatohen disa rregulla që nuk janë karakteristikë për çështjet e tjera dhe që në Kodin e Procedurës Civile sanksionohen ne titullin III dhe quhen "gjykimet e posaçme". Këto rregulla parashikohen nga nenet 324-333 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat rregullojnë "gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Sipas këtyre dispozitave gjykata duhet të verifikojë nëse akti administrativ është i ligjshëm apo i paligjshëm dhe nëse me këtë akt i cënohen interesat e të drejtat paditësit. Në këtë kuadër gjykata duhet të bëjë një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen. Kjo mund të realizohet nëpërmjet një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm (neni 14 i Kodit të Procedurës Civile). Nga cilësia e hetimit gjyqësor varet, në fund të fundit, zgjidhja e drejtë e çështjes dhe dhënia e një vendimi të bazuar dhe ligjor. E theksojmë këtë se për këto çështje gjykata e apelit nuk përsërit ndonjë hetim gjyqësor të mëparshëm, pjesërisht apo tërësisht, por e zhvillon atë vetë duke mbajtur parasysh, për aq sa janë të zbatueshme dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Biles gjatë gjykimit, me kërkesën e palëve ose edhe kryesisht, gjykata ka të drejtë të marrë edhe prova të reja.

Meqënëse për zgjidhjen e këtyre çështjeve duhen afate sa më të shkurtra ligjvënësi ka eliminuar gjykimin në gjykatën e rrethit si shkallë e parë, duke i kaluar direkt në gjykatën e apelit, si një gjykatë më e kualifikuar.

Në këto raste, megjithëse shkurtohet një shkallë gjykimi nuk kemi të bëjnë me mohim të lirive dhe të drejtave kushtetuese, pasi neni 42 i Kushtetutës parashikon se :"Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore.... ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj". Dhe nuk ka asnjë dyshim se gjykata e apelit i plotëson të gjitha standardet kushtetuese, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, dhe është një gjykatë më e kualifikuar se gjykata e shkallës së parë, që garanton të drejta dhe liritë e palëve në proces.

Vendimi i gjykatës së apelit është përfundimtar (neni 5/4 i ligjit nr.8227). Si i tillë, ai mund të kundërshtohet në Gjykatën e Lartë. Parashikimet e paragrafit të dytë të pikës "e" të nenit 5 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 nuk e kufizojnë të drejtën e asnjë personi të kërkojë të ushtrojë të drejtat e tij kushtetuese e ligjore.

Palët ndërgjygjëse ushtrojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në Kushtetutë dhe Kodin e Procedurës Civile. Mosparashkrimi në ligjin e zakonshëm i së drejtës së ankimit nuk i pengon subjektet e ndryshme të realizojnë të gjitha procedurat e ankimit (neni 43 i Kushtetutës). Çdo person, që gjykohet në gjykatën e apelit, si juridiksion fillestar, ka të drejtë të bëjë ankim në një gjykatë më të lartë në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për këtë çështje.

E drejta e ankimit është një e drejtë kushtetuese dhe ligjore dhe i njihet secilit prej palëve me

një nga mjetet që parashikon neni 442 i Kodit të Procedurës Civile. Meqënëse këto çështje gjykohen nga gjykata e apelit, e vetmja gjykatë më e lartë për ta është Gjykata e Lartë. Konkretisht është rekursi, ankimi që investon gjykimin në Gjykatën e Lartë për shkaqe që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

Edhe në këto raste, Gjykata e Lartë nuk mund të gjykojë si Gjykatë Apeli pavarësisht nëse jaën zhvilluar dy apo një gjykim më parë, sepse juridiksioni i Gjykatës së Lartë përcaktohet shprehimisht në Kushtetutë në nenin 141 ku thuhet:

"Gjykata e Lartë ka jurisikion fillestar dhe rishikues ...." juridiksioni fillestar në çështjen objekt gjykimi i takon gjykatës së apelit, kurse Gjykata e Lartë ruan funkionin e rishikimit.

Juridikisoni i Gjykatës së Lartë për çështje civile është vetëm juridiksion rishikues Prandaj theksojmë se vendimet e gjykatave të apelit mund të ankimohen vetëm nëpërmjet rekurseve. Për shqyrtimin e rekurseve do të zbatohen normat proceduriale të parashikuara nga neni 472 e në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile. Në zbatim të dispozitave proceduriale, Gjykata e Lartë është e detyruar të verifikojë së pari nëse nga gjykata e apelit është respektuar ligji, së dyti nëse gjatë gjykimi janë respektuar të drejtat e palëve dhe së treti nëse është respektuar procedura e gjykimit. Pajtohem me konkluzionet, në të cilat kanë arritur Kolegjet e Bashkuara lidhur me pikën e parë dhe të dytë, për respektimin e ligjit dhe të drejtave të palëve, por mendoj se duhen orientuar gjykatat e apelit, se këto lloj gjykimesh janë të posaçme. Në çështjet objekt gjykimi kundërshtohet një akt administrativ. Për mosmarrëveshjet administrative në Kodin e Procedurës Civile parashikohet një gjykim i posaçëm, që e kemi cituar më sipër. Normat proceduriale të parashikuara për këtë lloj gjykimi janë të detyrueshme për gjykatat e apelit.

Lidhur me pyetjen nëse këto çështje do të kalojnë direkt për gjykim në kolegj apo do të diskutohen fillimisht në dhomën e këshillimit (neni 480 i Kodit të Procedurës Civile) mendojmë se rekursi në këto raste do të trajtohet, si dhe të gjitha rekurset e tjera. Rekursi mund të mos pranohet në qoftë se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato, që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

Mospranimi i rekursit edhe në këto raste vendoset nga kolegji në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve sipas kërkesave proceduriale.

GJYQTARI
Y. Myrtja

Tiranë, më 15.9.2000
Nr.2177/850 i Regj. Themeltar
Nr. 1030 i Vendimit

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 12.12.2000
Doli nga shtypi më 14.12.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 150 lekë